



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 11 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIME	2
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	5
	A. Shqyrtimi i Aktakuzës	5
	B. Veprat penale në bazë të nenit 15(2) të Ligjit dhe format e përgjegjësive penale.....	6
	C. Ruajtja e konfidencialitetit	7
IV.	JURISDIKSIONI	8
	A. Juridiksioni lëndor.....	8
	B. Juridiksioni kohor.....	9
	C. Juridiksioni territorial ose individual	9
V.	KRITERET LIGJORE	10
	A. Lloji dhe fushëveprimi i shqyrtimit	10
	1. Lloji i shqyrtimit	10
	2. Fushëveprimi i shqyrtimit.....	12
	B. Elementet e krimeve	14
	1. Shkelja e fshehtësisë së procedurës.....	14
	2. Hakmarrja	19
	3. Frikësimi gjatë procedimit penal.....	20
	4. Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare	22
	C. Format e përgjegjësive penale	26
	1. Kryerja	26
	2. Bashkëkryerja.....	26
	3. Nxitja.....	27
	4. Ndihma.....	28
	5. Marrëveshja për të kryer veprë penale.....	28
	6. Tentativa.....	29
VI.	AKUZAT	30
	A. Krimet e paraqitura në aktakuzë	30
	1. Shkelja e fshehtësisë së procedurës – informacioni i mbrojtur (Pika 5).....	30
	2. Shkelja e fshehtësisë së procedurës – personat e mbrojtur (Pika 6)	34
	3. Hakmarrje (Pika 4)	37
	4. Frikësimi gjatë procedurës penale (Pika 3).....	39
	5. Pengimi i personave zyrtarë – me anë të kërcënimit të rëndë (Pika 1).....	42
	6. Pengimi i personave zyrtarë – me anë të veprimit të përbashkët të një grupi (Pika 2)	46
	B. Format e përgjegjësive penale në aktakuzë	47
	1. Kryerja	47
	2. Bashkëkryerja.....	48
	3. Nxitja.....	49
	4. Ndihma.....	51
	5. Marrëveshje për të kryer veprë penale.....	53
	6. Tentativa.....	54
VII.	KËRKESAT SHOQËRUESE PËR RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT	55
VIII.	VENDIM	57

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ bazuar në nenin 39(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 86 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr vendimin në vijim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 30 tetor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (“Aktakuza”) kundër Hysni Gucati (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”) (bashkërisht, “të dyshuarit”), së bashku me materialet provuese në mbështetje të fakteve materiale mbi të cilat bazohen akuzat si dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë (“Parashtrimi i Aktakuzës nga ZPS-ja”).²

2. Më 3 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi datën 11 dhjetor 2020 si datën e synuar për dhënien e këtij vendimi.³

II. PARASHTRIME

3. Në Aktakuzë, ZPS-ja i akuzon të dyshuarit për vepra penale të parashikuara në nenin 15(2) të Ligjit dhe në nenet 387, 388(1), 392(1)-(3) dhe 401(1)-(3) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës, Ligji Nr. 06/L-074 (2019) (“KPK”), në lidhje me procedurat

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00063, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimi i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me të* (“Parashtrimi i Aktakuzës nga ZPS-ja”), 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1 (“Aktakuza”) dhe 2 (“Përmbledhja e Detajuar”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-07, F00072, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Procedurën lidhur me Rishikimin e Paraburgimit dhe Caktimin e Datës për Lëshimin e Vendimit sipas Nenit 39(2)*, 3 dhjetor 2020, konfidencial, para. 20.

zyrtare të Dhomave të Specializuara ("DHS"), përfshirë hetimet e ZPS-së.⁴ Më konkretisht, ZPS-ja pretendon se veprimet dhe mosveprimet e të dyshuarve midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020 i ngarkojnë ata me përgjegjësi penale për sa më poshtë:

- (i) pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet forcës dhe/ose kërcënimit të rëndë, e ndëshkueshme sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së (Pika 1);
- (ii) pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe nenit 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së (Pika 2);
- (iii) frikësim gjatë procedurës penale, e ndëshkueshme sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe nenit 387 të KPK-së (Pika 3);
- (iv) hakmarrje, e ndëshkueshme sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe nenit 388(1) të KPK-së (Pika 4);
- (v) shkelje e fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacioneve të fshehta të nxjerrë në procedura zyrtare, e ndëshkueshme sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe nenit 392(1) të KPK-së (Pika 5); dhe
- (vi) shkelje e fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, e ndëshkueshme sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe nenit 392(2)-(3) të KPK-së (Pika 6).⁵

4. Sipas ZPS-së, të dyshuarit ngarkohen me përgjegjësi penale individuale në bazë të nenit 16(3) të Ligjit sepse:

⁴ Aktakuza, hyrja, para 4, 48.

⁵ Aktakuza, para. 48.

- (i) kanë kryer, veças ose në bashkëpunim, veprat penale të paraqitura në Pikat 1-6, brenda kuptimit të neneve 17 dhe 31 të KPK-së;⁶
- (ii) kanë tentuar të kryejnë veprat penale të paraqitura në Pikat 1-4 dhe 6, brenda kuptimit të nenit 28 të KPK-së;⁷
- (iii) janë marrë vesh të kryejnë dhe kanë ndërmarrë veprime të rëndësishme për kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6 si bashkëkryes, brenda kuptimit të nenit 35 të KPK-së;⁸
- (iv) kanë nxitur kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6, brenda kuptimit të nenit 32(1) të KPK-së;⁹
- (v) kanë nxitur kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6 dhe vepra të tilla u tentuan të kryheshin, brenda kuptimit të nenit 32(2) të KPK-së;¹⁰
- (vi) kanë nxitur kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-3 dhe 6 dhe vepra të tilla as nuk u kryen dhe as u tentuan të kryhen, brenda kuptimit të nenit 32(3) të KPK-së;¹¹ dhe/ose
- (vii) kanë ndihmuar në kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6, brenda kuptimit të nenit 33 të KPK-së.¹²

5. ZPS-ja parashtron më tej se të dyshuarit synonin të kryenin dhe/ose nxitën ose ndihmuar kryerjen (e tentuar) të veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6.¹³ Si alternativë, ZPS-ja parashtron se të dyshuarit: (i) ishin të vetëdijsëm se si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të tyre, mund të kryheshin veprat penale të paraqitura në Pikat 1-6, dhe/ose se veprimet apo mosveprimet e tyre mund të

⁶ Aktakuza, para 37, 39, 47(i).

⁷ Aktakuza, para 38, 47(ii).

⁸ Aktakuza, para 39-40, 47(iii).

⁹ Aktakuza, para 41, 47(iv).

¹⁰ Aktakuza, para 42, 47(v).

¹¹ Aktakuza, para 43, 47(vi).

¹² Aktakuza, para 44, 47(iv).

¹³ Aktakuza, para. 45.

nxisnin kryerjen e veprave penale apo të ndihmonin në kryerjen e tyre; dhe (ii) u pajtuan me kryerjen e tyre.¹⁴

6. ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake konfirmimin e Aktakuzës.¹⁵

7. Krahas kësaj, ZPS-ja kërkon: (i) mosnxjerrjen e përkohshme për publikun dhe të dyshuarit të Aktakuzës, të dokumenteve dhe informacionit shoqërues deri në një urdhër të mëtejshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake pas një kërkesë të ZPS-së apo pas dëgjimit të argumenteve të ZPS-së; dhe (ii) autorizim për redaktimin e çdo informacioni identifikues të dëshmitarëve dhe të viktimave apo të informacioneve konfidenciale përpara nxjerrjes, sipas rastit, për të dyshuarit apo publikun.¹⁶ ZPS-ja parashtron se masat e kërkuara justifikohen duke pasur parasysh se të dyshuarit dhe disa të tjerë në mënyrë të përsëritur kanë shpërndarë pa autorizim informacion konfidencial dhe jopublik, [REDAKTUAR] dhe kanë ndërmarrë masa për të frikësuar dhe për t'u hakmarrë ndaj dëshmitarëve dhe për të penguar punën e ZPS-së dhe procesin e DHS-së.¹⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. SHQYRTIMI I AKTAKUZËS

8. Neni 39(1) dhe (2) i Ligjit dhe rregulla 86(4) e Rregullores përcaktojnë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencën të shqyrtojë aktakuzën. Në bazë të nenit 39(2) të Ligjit dhe rregullës 86(4) dhe (5) të Rregullores, në qoftë se bindet se Prokurori i Specializuar ka vërtetuar ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konfirmon aktakuzën. Në qoftë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bindet për këtë, aktakuza ose akuzat e përfshira në të

¹⁴ Aktakuza, para. 46.

¹⁵ Parashtrimi i Aktakuzës nga ZPS-ja, para. 9(a).

¹⁶ Parashtrimi i Aktakuzës nga ZPS-ja, para 5, 9(b).

¹⁷ Parashtrimi i Aktakuzës nga ZPS-ja, para. 6.

hidhen poshtë. Rregulla 86(5) e Rregullores përcakton që gjykatësi i procedurës paraprake duhet të japë një vendim të arsyetuar.

9. Në bazë të rregullës 86(3) të Rregullores, në aktakuzë duhet të jepen emri dhe të dhënat personale të të dyshuarit dhe një përshkrim i shkurtër i fakteve të çështjes dhe i veprës apo veprave penale për të cilat akuzohet i dyshuari, në veçanti forma e përgjegjësisë penale të pretenduar në lidhje me krimet e paraqitura në aktakuzë. Aktakuza dorëzohet së bashku me materialin mbështetës, konkretisht me materialin provues që mbështet faktet mbi të cilat bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.

10. Pas konfirmimit të akuzës ose akuzave në aktakuzë, rregulla 86(6) e Rregullores përcakton që i dyshuari bëhet i akuzuar dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të lëshojë vendime ose urdhra të tjerë të paraparë në nenin 39(3) të Ligjit.

11. Rregulla 86(8) dhe (10) e Rregullores përcakton që Administratori ruan aktakuzën e konfirmuar dhe përgatit kopje të legalizuara të aktakuzës së konfirmuar me vulën e Dhomave të Specializuara dhe njofton Kryetarin për aktakuzën e konfirmuar.

B. VEPRAT PENALE NË BAZË TË NENIT 15(2) TË LIGJIT DHE FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

12. Sipas nenit 3(2) të Ligjit, Dhomat e Specializuara gjykojnë në pajtim, ndër të tjera, me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin, dispozitat e legjislacionit kosovar të përfshira shprehimisht në Ligj dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

13. Në bazë të neneve 6(2) dhe 15(2) të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi vepra penale të veçanta kundër administrimit të drejtësisë, siç parashikohet në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, Ligji Nr. 04/L-082 (“KPK 2012”), kur këto kanë të bëjnë me procedurat zyrtare dhe me zyrtarët e DHS-së dhe të ZPS-së. KPK-ja që ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019¹⁸ i ka rinumërtuar dispozitat e përmendura në nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit. Për rrjedhojë, procesi aktual mbështetet në nenet 387, 388, 392 dhe 401 të KPK-së, që përkojnë me nenet 395, 396, 400 dhe 409 të KPK 2012.¹⁹

14. Për veprat penale të nenit 15(2) të Ligjit, neni 16(3) përcakton se zbatohen dispozitat e përgjegjësisë penale individuale që përmban KPK 2012, nenet 8-10, 17, 21-24, 27-40. Këto dispozita janë rinumërtuar në KPK si nenet 8-10, 17, 21-24, 27-37.

C. RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT

15. Neni 39(11) i Ligjit përcakton që, kur është e nevojshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të sigurojë mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

16. Rregulla 85(4) e Rregullores përcakton që, varësisht prej rregullës 102 të Rregullores, të gjitha dokumentet dhe informacionet që ZPS-ja i paraqet Gjykatësit të Procedurës Paraprake gjatë hetimit, mbeten më së paku rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

17. Rregulla 88 e Rregullores përcakton se aktakuza bëhet publike pas konfirmimit prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Megjithatë, në rrethana të veçanta, pasi janë paraqitur arsye të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake

¹⁸ *Shih* nenin 434 të KPK-së, botuar në *Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës*, nr. 2, 14 janar 2019, Prishtinë.

¹⁹ *Shih edhe* KSC-BC-2020-07, F00057, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes* (“Vendimi mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes”), 27 tetor 2020, publik, para. 24.

mund të urdhërojë përkohësisht mosnxjerrjen publike të aktakuzës, dokumenteve ose informacionit që ka lidhje me të deri në një urdhër të mëtejshëm. Sidoqoftë, aktakuza bëhet publike me redaktimet e nevojshme, jo më vonë se paraqitja e parë e të akuzuarit. ZPS-ja mund t'ua bëjë të njohur aktakuzën ose një pjesë të saj autoriteteve të një shteti të tretë apo subjekti tjetër, në qoftë se e gjykon të nevojshme për hetime ose ndjekje penale.

18. Rregulla 102(1)(a) e Rregullores përcakton që ZPS-ja i vë në dispozicion të akuzuarit, sa më shpejt që të jetë e mundshme, por të paktën brenda 30 ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarit, materialet mbështetëse të aktakuzës së dorëzuar për konfirmim si dhe të gjitha deklaratat e marra prej të akuzuarit.

19. Rregulla 105(1) e Rregullores përcakton që ZPS-ja mund t'i bëjë kërkesë panelit për mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të një dëshmitari ose viktime pjesëmarrëse në proces deri sa të jenë urdhëruar masat e përshtatshme mbrojtëse.

IV. JURISDIKSIONI

20. Që të konfirmohet, aktakuza duhet të plotësojë kriterin lëndor dhe kohor dhe duhet të bazohet në elementin territorial, ose individual të juridiksionit.

A. JURIDIKSIONI LËNDOR

21. Nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit parashikojnë se DHS-ja ka juridiksion mbi veprat penale të frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes, shkeljes së fshehtësisë së procedurës dhe pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, duke iu referuar përkatësisht neneve 395, 396, 400 dhe 409 të KPK 2012, që

përkojnë me nenet 387, 388, 392 të 401 të KPK-së. Si rrjedhojë, këto krime i përkasin juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara.²⁰

B. JURIDIKSIONI KOHOR

22. Veprat penale të renditura në nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit kanë të bëjnë me zyrtarët ose me procedurat zyrtare të DHS-së apo të ZPS-së, institucione të krijuara me ligj në vitin 2015.²¹ Për rrjedhojë, vepra të tilla duhet të kenë lidhje me ngjarje pas krijimit të këtyre institucioneve. Veprat penale të përfshira në Pikat 1-6 kanë të bëjnë me ngjarje që pretendohet se kanë ndodhur midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020 dhe, për rrjedhojë, përfshihen në juridiksionin kohor të DHS-së.²²

C. JURIDIKSIONI TERRITORIAL OSE INDIVIDUAL

23. Në bazë të nenit 8 të Ligjit, DHS ka juridiksion mbi krime brenda juridiksionit të saj lëndor të cilat kanë filluar të kryhen ose janë kryer në Kosovë. Në bazë të nenit 9(2) të Ligjit, DHS ka juridiksion individual kur të dyshuarit janë individë me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë ("RFJ") (parimi i personalitetit aktiv) ose krimet janë kryer kundër personave me shtetësi të Kosovës/RFJ-së (parimi i personalitetit pasiv), kudo që të jenë kryer. Elementi territorial dhe individual të juridiksionit janë alternativa të njëri-tjetrit. Përmbushja e njërit prej këtyre kriterëve është e mjaftueshme për të bërë konstatim konfirmues në lidhje me juridiksionin.

²⁰ *Shih edhe* Vendimin mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes, para 23-24.

²¹ *Shih* nenin 162(1) të Kushtetutës; nenin 1(1) të Ligjit.

²² *Shih edhe* Vendimin mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes, para 25-26.

24. Për rastin në fjalë, të dyshuarit janë shtetas të Kosovës gjatë të gjitha periudhave që kanë lidhje me Aktakuzën.²³ Për këtë arsye Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është përmbushur kriteri juridiksional i personalitetit aktiv të nenit 9(2) të Ligjit.

25. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se çështja është brenda juridiksionit të DHS-së.

V. KRITERET LIGJORE

A. LLOJI DHE FUSHËVEPRIMI I SHQYRTIMIT

1. Lloji i shqyrtimit

26. Konfirmimi i aktakuzës është një proces *ex parte* pa përfshirjen e Mbrojtjes. Shqyrtimi në procedurë paraprake siguron që në gjykim të shqyrtohen vetëm ato akuza për të cilat janë paraqitur prova të mjaftueshme. Gjithashtu ai siguron që aktakuza t'i japë të akuzuarit informacion të mjaftueshëm për të kuptuar qartë dhe plotësisht llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij, me qëllim përgatitjen e një mbrojtjeje adekuate.²⁴

27. Në bazë të nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(1) të Rregullores, Prokurori i Specializuar dorëzon aktakuzën së bashku me materialin mbështetës për t'u shqyrtuar prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Gjatë procesit të shqyrtimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton nëse aktakuza plotëson kushtet e rregullës 86(3) të Rregullores, dhe nëse është nevoja e kthimit tek Prokurori i Specializuar në bazë të rregullës 86(4) të Rregullores. Në vijim, në bazë të nenit 39(2) të Ligjit dhe përcaktimeve të përgjithshme të rregullës 86(4) të Rregullores,

²³ Aktakuza, para 1-2. KSC-BC-2020-07, Transkript, 29 shtator 2020, publik, f. 3, rreshtat 20-23; Transkript, 1 tetor 2020, publik, f. 5, rreshtat 22-23.

²⁴ KSC-BC-2020-05, F00003, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me Rregullën 86(4) të Rregullores*, 28 shkurt 2020, publik, para. 9.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton materialin mbështetës në lidhje me secilën prej akuzave në aktakuzë për të përcaktuar nëse ZPS-ja ka vërtetuar ekzistencën e një dyshimi të bazuar mirë se i dyshuari ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një krimi të përfshirë në juridiksionin e DHS-së

28. Ndonëse as Ligji e as Rregullorja nuk e përkufizojnë dyshimin e bazuar mirë, bëhet diferencim i qartë i këtij standardi prej standardeve të tjera të provave që parashihen në kornizën ligjore të DHS-së. Ligji parasheh katër standarde provash me përshkallëzim progresiv: (i) arsye për të besuar (në nenin 38(3)(a) të Ligjit dhe rregullën 43(1) të Rregullores, lidhur me statusin e të dyshuarve); (ii) dyshim i bazuar (në nenin 41(6) të Ligjit, lidhur me fletarrestimet e DHS-së ose urdhërarrestimet e ZPS-së); (iii) dyshim i bazuar mirë (në nenin 39(3) të Ligjit dhe rregullën 86(4) të Rregullores, lidhur me konfirmimin e një aktakuze); dhe (iv) jashtë dyshimit të arsyeshëm (në nenin 21(3) të Ligjit dhe rregullën 158(3) të Rregullores, lidhur me vendimet e fajësisë). Për fillimin e procedimit kundër një të akuzuari, standardi i dyshimit të bazuar mirë është domosdoshmërisht më i lartë se sa standardet e kërkuara për përcaktimin se kush janë të dyshuarit dhe për urdhërimin e arrestimeve, si dhe është qartësisht më i ulët se sa standardi i vendimit të fajësisë pas zhvillimit të gjykimit.

29. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në bazë të nenit 19.1.12 të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Kosovës 2012, ("KPP"), dyshimi i bazuar mirë arrihet kur provat "do të bindnin një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri".²⁵ Në veçanti, nuk është e mjaftueshme, sikurse kërkohet në lidhje me dyshimin e bazuar sipas nenit 19.1.9

²⁵ Termi "objektiv" përkufizohet (në anglishte) si "që nuk ndikohet nga ndjenjat dhe mendimet vetjake në shqyrtimin dhe përshkrimin e fakteve", *shih OED Online* (Oxford University Press, dhjetor 2019), gjendet në <https://www.oed.com/view/Entry/129634?redirectedFrom=objective&> parë për herë të fundit më 3 dhjetor 2020.

të KPP-së, që vëzhguesi objektiv të bindet se “ka më shumë gjasa që personi në fjalë të ketë kryer veprën penale se sa të mos e ketë kryer”.

30. Rrjedhimisht, ndonëse më i ulët se standardi i qartësisë së një fakti të vërtetuar, përcaktimi i ekzistencës së dyshimit të bazuar mirë gjithsesi kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bindet, përtej teorisë apo dyshimit të thjeshtë se: (i) krimet kanë ndodhur në të vërtetë; dhe (ii) i dyshuari ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e krimit përmes formës ose formave të pretenduara të përgjegjësisë penale. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i bazon këto konstatime në material mbështetës konkret dhe të qartë që demonstroi një linjë të qartë arsyetimi mbi të cilën bazohen akuzat në aktakuzë. Duke bërë këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e vlerëson materialin mbështetës në tërësinë e tij, pa bërë shqyrtim të imtë të secilës prej provave.²⁶

2. Fushëveprimi i shqyrtimit

31. Në bazë të rregullës 86(4) të Rregullores, për të përcaktuar nëse ekziston dyshimi i bazuar mirë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton vetëm aktakuzën, përmbledhjen e detajuar dhe materialin mbështetës, pa marrë parasysh informacione apo materiale të tjera jothelbësore, edhe nëse këto janë të disponueshme publikisht. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund ta konfirmojë ose hedhë poshtë aktakuzën vetëm mbi bazën e informacionit dhe materialit provues të dorëzuar nga ZPS-ja.²⁷

²⁶ KSC-BC-2020-05, F00008/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës (“Vendimi i Konfirmimit Mustafa”)*, 5 tetor 2020, publik, para. 37. Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-803-tEN, Pre-Trial Chamber I, *Decision on the Confirmation of Charges*, 29 January 2007, para. 39; *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-656-Red, Pre-Trial Chamber I, *Decision on the Confirmation of Charges Against Laurent Gbagbo*, 12 June 2014, para. 22.

²⁷ Vendimi i Konfirmimit Mustafa, para. 38. Në mënyrë të ngjashme, STL, STL-17-07/I/AC/R176bis, Appeals Chamber, *Interlocutory Decision on the Applicable Law: Criminal Association and Review of the Indictment*, 18 October 2017, para. 111.

32. Si pjesë e procesit të shqyrtimit, për përcaktimin e pranueshmërisë dhe rëndësisë së provave sikurse parashihet në rregullat 137-139 të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kryen një vlerësim paraprak të materialit mbështetës, pa ndërhyrë në kompetencat e trupit gjykues.²⁸ Pavarësisht nga kjo, gjykatësi i procedurës paraprake nuk mbështetet në material që është qartësisht (i) joautentik ose (ii) është siguruar përmes një shkeljeje të Ligjit, Rregullores, ose standardeve të së drejtës së të drejtave të njeriut, ose përmes torturës apo çfarëdo forme të trajtimit çnjerëzor apo poshtëruës, sikurse parashihet në rregullën 138(2)-(3) të Rregullores.

²⁸ Vendimi i Konfirmimit *Mustafa*, para. 39. Në mënyrë të ngjashme, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al./ STL-11-01/I*, Pre-Trial Judge, *Decision Relating to the Examination of the Indictment of 10 June 2011 Issued Against Mr Salim Jamil Ayyash, Mr Mustafa Amine Badreddine, Mr Hussein Hassan Oneissi & Mr Assad Hassan Sabra*, 28 June 2011, para. 26.

B. ELEMENTET E KRIMEVE

1. Shkelja e fshehtësisë së procedurës

33. Shkelja e fshehtësisë së procedurës, brenda kuptimit të nenit 392 të KPK-së, ka disa forma. ZPS-ja i akuzon të dyshuarit në bazë të nenit 392(1) të KPK-së (Pika 5) dhe nenit 392(2)-(3) të KPK-së (Pika 6), elementet e të cilave parashtrohen më poshtë.

(a) Zbulimi i paautorizuar i informacionit të mbrojtur

Elementet materiale

34. Krimi i shkeljes së fshehtësisë së procedurës, brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së, kryhet (i) përmes zbulimit të paautorizuar të (ii) informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare (iii) që nuk duhet zbuluar në pajtim me ligjin dhe që është shpallur si i fshehtë me vendim të gjykatës apo të një autoriteti kompetent (“informacioni i mbrojtur”).

35. Neni 392(1) i KPK-së nuk e kufizon mënyrën me të cilën zbulohet informacioni. Rrjedhimisht, zbulimi mund të përfshijë afishimin, transmetimin apo shpërndarjen e materialit, në origjinal ose në formë të kopjuar/të incizuar, citimin ose referimin e përmbajtjes së materialit, si edhe duke u mundësuar të tjerëve për ta lexuar, kopjuar apo incizuar materialin apo përmbajtjen e tij. Një zbulim i tillë konsiderohet “i paautorizuar” nëse nuk lejohet me ligj apo me vendim të gjykatës apo të një autoriteti kompetent.

36. Në përputhje me KPK-në dhe KPPK-në, hetimet e prokurorisë përfshihen brenda kuadrit të “procedurës zyrtare”.²⁹ Për këtë arsye, hetimet e ZPS-së e përmbushin kushtin si “procedura zyrtare” sipas kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.³⁰

37. Për qëllimet e nenit 392(1) të KPK-së brenda kuadrit ligjor të DHS-së, “informacioni i mbrojtur” është çdo informacion apo material në lidhje me të cilin:

- a) Ligji, Rregullorja apo çdo ligj tjetër i zbatueshëm para DHS-së kërkon mbrojtje. Në veçanti, neni 62 i Ligjit parashikon se dokumentet, letrat, të dhënat dhe arkivat e DH-së, përfshirë Zyrën Administrative, dhe të ZPS-së nuk konsiderohen dokumente publike të Kosovës dhe se nuk ekziston e drejta e përgjithshme për të pasur qasje në to;
- b) një panel i DHS-së³¹ ka urdhëruar masa mbrojtjeje, ndër të tjera në pajtim me nenet 23, 39(11), 40(6)(d), 54(8), 58, 61(3), 62(2) të Ligjit, rregullat 82, 105, 108 të Rregullores apo çdo ligj tjetër të zbatueshëm. Kjo përfshin edhe çdo të dhënë gjyqësore të shënuar si “rreptësisht konfidenciale”, “konfidenciale” apo “limité”;³²
- c) ZPS-ja ka miratuar, me nismën e vet, masa mbrojtëse, ndër të tjera në pajtim me nenet 35(2)(f), 54(8), 61(4) të Ligjit, rregullat 30(2)(a), 82, 106, 107(1) të Rregullores ose ndonjë ligj tjetër të zbatueshëm. Kjo përfshin çdo material që u përket hetimeve të ZPS-së, përfshirë bashkëpunimin

²⁹ Neni 376 i KPK-së e përkufizon “procedurën zyrtare” si çfarëdo procedure penale siç përkufizohet në KPPK. Neni 6(2) i KPPK-së parashikon se “procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale”. Neni 101 i KPPK-së rregullon “Fillimin e procedurës penale me fazën e hetimit formal apo ngritjen e aktakuzës”.

³⁰ *Shih edhe* KSC-BC-2020-07, F00012, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020, publik, para 17, 26, poshtëshënimi 44; *Vendimi mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes*, para. 26, poshtëshënimi. 36.

³¹ Rregulla 2 e Rregullores e përkufizon “panelin” si “cilido panel/trup gjykues, ose gjykatës i caktuar në një çështje në përputhje me nenin 25(1) dhe nenin 33 të Ligjit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe”.

³² Rregulla 82(1) e Rregullores; KSC-AD-13-v2.2, *Direktiva Administrative për Administrimin e Aseteve të Informacionit*, 22 korrik 2020.

me subjekte të tjera, si edhe çdo dokument të shënuar ose të referuar si “konfidencial” apo “të brendshëm”.³³

Elementi mendor

38. Kryesi duhet të ketë vepruar me synim të drejtpërdrejtë ose eventual , brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

39. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë dhe dëshirën për të zbuluar pa autorizim informacion të mbrojtur të bërë të ditur në procedurë zyrtare.

40. Për synimin eventual, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë se, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të tij, mund të zbulohet pa autorizim informacion i mbrojtur i bërë i ditur në procedurë zyrtare dhe kryesi pajtohet me pasojën.

(b) Zbulimi i paautorizuar i identitetit dhe të dhënave personale të personave të mbrojtur

Elementet materiale

41. Vepra e shkeljes së fshehtësisë së procedurës, brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së, kryhet (i) përmes zbulimit të paautorizuar (ii) të identitetit ose të dhënave personale të (iii) personit të marrë në mbrojtje në procedurë penale ose në një program të posaçëm mbrojtjeje (“personi i mbrojtur”).

42. Kjo vepër penale është nënkategori e zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur dhe ndëshkohet me një dënim më të rëndë.

³³ 084015-084026, para 29, 35 (084019, 084021).

43. Sa i takon zbulimit të paautorizuar të informacionit, si bazë përdoren konstatimet e bëra më lart.³⁴

44. Në kuptim të nenit 392(2) të KPK-së brenda kuadrit ligjor të DHS-së, “personi i mbrojtur” është çdo person në lidhje me të cilin:

- a) një panel i DHS-së ka urdhëruar masa mbrojtëse, ndër të tjera në pajtim me nenet 23, 39(11), 40(6)(f), 58 të Ligjit, rregullat 80, 81, 105, 108 të Rregullores ose ligj tjetër të zbatueshëm. Këtu përfshihet çdo dëshmitar, viktimë apo person tjetër që ndërvepron me DHS-në identiteti dhe të dhënat personale të të cilit mbrohen me anë të masave të tilla;
- b) ZPS-ja ka miratuar, me nismën e vet, masa mbrojtjeje, ndër të tjera në pajtim me nenin 35(2)(f) të Ligjit, rregullën 30(2)(a) të Rregullores ose çdo ligj tjetër të zbatueshëm. Këtu përfshihet çdo person që ndërvepron me ZPS-në identiteti dhe të dhënat personale të të cilit mbrohen me anë të masave të tilla;
- c) në bazë të nenit 62 të Ligjit dhe pavarësisht nga mungesa e masave mbrojtëse të urdhëruara nga DHS-ja apo të miratuara nga ZPS-ja, zbatohet një detyrim i përgjithshëm moszbulimi. Këtu përfshihet çdo person që i ka dhënë informacion ZPS-së, në kuadër të hetimeve të saj, ose identiteti dhe/ose të dhënat personale të të cilit janë në materialin që një palë e tretë i jep ZPS-së.

45. Neni 392(2) i KPK-së përcakton që informacioni i cili nuk duhet zbuluar duhet të ketë lidhje me persona të mbrojtur. “Identiteti” përfshin të dhëna të tilla si: mbiemri apo mbiemrat, përfshirë edhe mbiemrin e vajzërisë apo mbiemrat e mëparshëm, emri apo emrat dhe çdo pseudonim të mëparshëm apo të tanishëm. “Të dhënat personale” përfshijnë informacione si: numri personal i identifikimit;

³⁴ Shih më lart para. 35 (Zbulimi i paautorizuar i informacionit të mbrojtur).

data dhe vendi i lindjes; adresa apo vendbanimi i mëparshëm apo i tanishëm; natyra, vendndodhja, koha dhe/ose kohëzgjatja e marrëdhënieve të mëparshme ose të tanishme të punës; identiteti i familjarëve; përkrimi ose vendndodhja e pasurive të rëndësishme (shtëpia, vetura); dhe çdo e dhënë tjetër që mund të çojë në identifikimin e personit.

46. Forma bazë e kësaj vepre penale, siç parashikohet në nenin 392(2) të KPK-së, nuk kërkon që zbulimi i paautorizuar të çojë në dëmtim apo në ndonjë pasojë tjetër të ndaluar. Neni 392(3) i KPK-së ndëshkon një formë të rënduar të kësaj vepre penale, kur zbulimi i paautorizuar rezulton me: (i) pasoja të rënda për personin e mbrojtur; ose (ii) procedura penale bëhet e pamundur ose vështirësohet në masë të madhe. Pasoja e rëndë mund të përfshijë cenimin thelbësor të sigurisë, mbrojtjes, mirëqenies, jetës private ose dinjitetit të personave të mbrojtur ose familjeve të tyre. Pamundësimi ose vështirësimi në masë të madhe i procedurës penale mund të përfshijë pamundësinë ose vështirësinë rezultuese në marrjen e provave, ruajtjen e sigurisë së procedurës apo të dëshmitarëve, si edhe devijimin e burimeve të konsiderueshme për t'u dhënë zgjidhje pasojave të tilla.

Elementi mendor

47. Kryesi duhet të ketë vepruar me synim të drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

48. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë dhe dëshirën për të zbuluar pa autorizim identitetin ose të dhënat personale të personave të mbrojtur.

49. Për synimin eventual, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë se, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të tij, mund të zbulohen pa autorizim identiteti ose të dhënat personale të personave të mbrojtur dhe kryesi është pajtuar me pasojën.

50. Për të dyja format e synimit, kryesi duhet të ketë qenë në dijeni ose duhet të ketë pasur arsye të ishte në dijeni se po zbulonte identitetin ose të dhënat personale të personave të mbrojtur.³⁵

2. Hakmarrja

51. Vepra penale e hakmarrjes, brenda kuptimit të nenit 388 të KPK-së, ka disa forma. ZPS-ja i akuzon të dyshuarit në bazë të nenit 388(1) të KPK-së, elementet e të cilit paraqiten në vijim.

Elementet materiale

52. Vepra penale e hakmarrjes, brenda kuptimit të nenit 388(1) të KPK-së, kryhet (i) përmes një veprimi të dëmshëm (ii) ndaj cilitdo personi që i jep informata të vërteta policisë, hetuesit të autorizuar, prokurorit apo gjyqtarit lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale (“dhënësi i informacionit”).

53. Neni 388(1) i KPK-së nuk e përvijon kuadrin e veprimeve të dëmshme, por bën të ditur se një formë e një veprimi të tillë është ndërhyrja në punësimin e ligjshëm apo sigurimin e mjeteve të jetesës. Veprimet e dëmshme mund të përfshijnë edhe dhunën, kërcënimet e rënda, cenimin e sigurisë, mirëqenies, privatësisë, dinjitetit dhe çdo ndërhyrje tjetër të dëmshme ndaj personit ose ndaj familjarëve të tij të afërm.

54. Në kuptim të nenit 388(1) të KPK-së brenda kuadrit ligjor të DHS-së, “dhënësi i informacionit” është çdo person që i jep informacione Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”) dhe/ose ZPS-së për krime apo vepra penale që bien në juridiksionin e DHS-së.

³⁵ Për ngjashmëri, Kosovë, Gjykata e Apelit, M.Z., PAKR 336/16, Aktgjykim, 13 dhjetor 2016, f. 7-9.

Elementi mendor

55. Kryesi duhet të ketë vepruar me synim të drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

56. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë dhe dëshirën për të bërë veprime dëmtuese si hakmarrje kundër një personi për dhënien e informacioneve të vërteta policisë, një hetuesi të autorizuar, një prokurori apo një gjykatësi në lidhje me kryerjen faktike ose të mundshme të një vepre penale.

57. Për synimin eventual, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë se, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të tij, dikush mund të bëhet objekt i hakmarrjes për dhënien e informacioneve të vërteta policisë, një hetuesi të autorizuar, një prokurori apo një gjykatësi në lidhje me kryerjen faktike ose të mundshme të një vepre penale dhe kryesi është pajtuar me këtë pasojë.

3. Frikësimi gjatë procedimit penal

Elementet materiale

58. Vepra penale e frikësimit gjatë procedurës penale, brenda kuptimit të nenit 387 të KPK-së, kryhet (i) përmes forcës apo kërcënimit të rëndë apo ndonjë mënyre tjetër të detyrimit, premtimit të një dhurate apo ndonjë përfitimi tjetër (ii) ndaj një personi që po jep ose ka të ngjarë t'i japë informacion policisë, prokurorit apo gjyqtarit ("dhënësi i mundshëm i informacionit").

59. Neni 387 i KPK-së ndalon çdo sjellje që mund të ketë (ose pritët nga kryesi të ketë) ndikim ose influencë në deklaratën apo informacionin që mund të japë personi.

60. Neni 387 i KPK-së nuk përvijon çfarë përbën forcë, kërcënim të rëndë, shtrëngim apo çdo lloj mënyre tjetër të kryerjes së kësaj vepre. Rrjedhimisht, forca mund të përfshijë çdo formë të dhunës fizike apo të dehjes³⁶ të ushtruara ndaj një personi.³⁷ Kërcënimi i rëndë mund të përfshijë kërcënimet për të përdorur dhunë apo për të shkaktuar dëmtim të rëndë të shëndetit, mirëqenies, sigurisë apo privatësisë të një personi. Detyrimi ka të bëjë me çdo veprim kufizimi apo shtrëngimi të një personi.³⁸

61. Neni 387 i KPK-së mbulon çdo dëshmitar apo dëshmitar të mundshëm apo çdo informues tjetër të policisë ose të autoriteteve prokuroriale dhe gjyqësore. Brenda kuadrit ligjor të DHS-së, “dhënësi i mundshëm i informacionit” është çdo person që ka gjasa t’i japë informacion TFHS-së, ZPS-së dhe ose çdo paneli të DHS-së lidhur me krime ose vepra penale brenda juridiksionit të DHS-së.

62. Me formulimin e tij—“Kushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze [...] për të nxitur” —, neni 387 i KPK-së nuk kërkon provë që veprimet e lartpërmendura të kenë ndonjë pasojë të caktuar për personin, pra që ky person të mos ketë dhënë deklaratë, të ketë dhënë deklaratë të rreme apo të mos i ketë dhënë informacione të vërteta policisë, prokurorit apo gjyqtarit.³⁹ Nëse do të kërkohej ndryshe, do të thotë se elementet materiale të kësaj vepre penale do të bashkoheshin me ato të veprave penale të nenit 386 të KPK-së.⁴⁰ Ky interpretim përputhet më së miri edhe

³⁶ *Shih* nenin 113(15) të KPK-së.

³⁷ *Shih* *OED Online* (Oxford University Press, shtator 2020) <<https://www.oed.com/view/Entry/72847?rskey=1Dwx9g&result=1#eid>> accessed 3 December 2020.

³⁸ *Shih* *OED Online* (Oxford University Press, shtator 2020) <<https://www.oed.com/view/Entry/37937?redirectedFrom=compulsion#eid>> shikuar më 3 dhjetor 2020.

³⁹ *Për krahasim*, Kosovë, Gjykata e Apelit, *E.H. dhe I.H.*, PAKR.nr. 390/2019, *Aktgjykim*, 15 gusht 2019.

⁴⁰ Neni 386 i KPK-së përcakton se kushdo që me anë të detyrimit apo ryshfetit, me qëllim, ndër të tjera, (i) të nxitjes së ndonjë personi që të japë deklaratë të rreme, të ofrojë dokument të rremë apo të fshehtë ndonjë fakt material në procedurë zyrtare (paragrafi 1.1) apo (ii) të nxitjes së dëshmitarit apo ekspertit për të refuzuar dhënien e dëshmisë ose për të dhënë dëshmi të rreme në procedurë gjyqësore (paragrafi 1.7) dënohet për veprën e pengimit të të provuarit apo procedurës zyrtare. Termet e kësaj dispozite (“shkakton”, “nxit”) bëjnë të qartë se zbatohet për rastet kur kryesi shkakton ose nxit që një person të japë deklaratë të rreme, të fshehtë një fakt material apo të refuzojë dhënien e një deklaratë.

me qëllimin e dispozitës për mbrojtjen e të dhënave të dëshmitarëve dhe të dhënësve të tjerë të informacioneve dhe, më në përgjithësi, për mbrojtjen e integritetit të procedurës penale me anë të ndëshkimit të kryesit që synon të ushtrojë influencë mbi një dëshmitar.⁴¹

Elementi mendor

63. Kryesi duhet të ketë vepruar me synim të drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

64. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë dhe dëshirën për të përdorur forcën apo kërcënimin e rëndë apo ndonjë mënyrë tjetër detyrimi, për të premtuar dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të mos japë deklaratë ose të japë deklaratë të rreme, ose të mos u japë informacion të vërtetë policisë, prokurorit apo gjyqtarit.

65. Për synimin eventual, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë se, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të tij, personi tjetër mund të mos japë deklaratë, mund të japë deklaratë të rreme ose të mos i japë informacion të vërtetë policisë, prokurorit ose gjykatësit dhe kryesi është pajtuar me këtë pasojë.

4. Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare

66. Vepra penale e pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, brenda kuptimit të nenit 401 të KPK-së, ka disa forma. ZPS-ja ngre akuzë kundër

⁴¹ Për ngjashmëri, ICTY, *Prosecutor v. Beqaj*, IT-03-66-T-R77, Trial Chamber I, *Judgement on Contempt Allegations*, 27 May 2005, para. 21; *Prosecutor v. Haraqija and Morina*, IT-04-84-R77.4, Trial Chamber I, *Judgement on Contempt Allegations*, 17 December 2008, para. 18; ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, Trial Chamber VII, *Public Redacted Version of Judgment pursuant to Article 74 of the Statute*, ICC-01/05-01/13-1989-Red, 19 October 2016, paras 43, 48; *Prosecutor v. Bemba et al.*, Appeals Chamber, *Public Redacted Judgment on the appeals of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo, Mr Aimé Kilolo Musamba, Mr Jean-Jacques Mangenda Kabongo, Mr Fidèle Babala Wandu and Mr Narcisse Arido against the decision of Trial Chamber VII entitled "Judgment pursuant to Article 74 of the Statute"*, ICC-01/05-01/13-2275-Red, 8 March 2018, para. 737.

të dyshuarve në bazë të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së (Pika 1) dhe të nenit 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së (Pika 2), elementet e të cilave jepen në vijim.

(a) Pengimi i personave zyrtarë me forcë apo kërcënim të rëndë

Elementet materiale

67. Vepra penale e pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, brenda kuptimit të nenit 401(1) të KPK-së, kryhet (i) përmes forcës apo kërcënimit të rëndë, që çon në (ii) pengimin faktik apo tentativë për pengimin e një personi zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, ose në detyrimin e personit që të kryejë detyrën zyrtare.

68. Neni 401(1) i KPK-së nuk përkufizon se çfarë është forca apo kërcënim i rëndë. Kuptimi i këtyre është i krahasueshëm me atë të nenit 387 të KPK-së.⁴² Duhet theksuar se neni 401(1) i KPK-së nuk kërkon që forca apo kërcënim i rëndë të ushtrohet drejtpërdrejt ndaj personit zyrtar. Përkundrazi, forca apo kërcënim i rëndë mund të drejtohen ndaj një a më shumë personave, për sa kohë që rezulton në pengimin faktik ose në tentativën për pengim të një personi zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

69. Neni 113(2) i KPK-së e përkufizon “personin zyrtar”, ndër të tjera, si personi të cilit i janë besuar kryerja faktike e detyrave apo punëve të caktuara zyrtare. Brenda kuadrit ligjor të DHS-së, një “person zyrtar” i tillë do të ishte çdo person që vepron në emër të DHS-së ose të ZPS-së, përfshirë gjykatës, prokurorë, hetues apo çdo zyrtar tjetër të DHS-së apo të ZPS-së (“zyrtari i DHS-së/ZPS-së”). Sipas nenit 401(5) të KPK-së, quhet rrethanë rënduese nëse vepra penale kryhet, ndër të tjera, ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë ose personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria. Rrjedhimisht, kur vepra penale

⁴² *Shih më lart* para. 60 (Frikësimi gjatë procedimit penal).

e parashikuar në nenin 401(1) të KPK-së kryhet kundër një zyrtari të DHS-së/ZPS-së, janë përmbushur kriteret e rrethanës rënduese. Në kuadrin e nenit 401(1) të KPK-së dhe brenda kuptimit të kuadrit ligjor të DHS-së, “detyrat zyrtare” të zyrtarit të DHS-së/ZPS-së kanë të bëjnë me çdo përgjegjësi apo punë në kuadër të procedurave zyrtare të Dhomave të Specializuara, përfshirë hetimet e ZPS-së (“procedurat e DHS-së”).

70. Termi “pengoj” do të thotë të parandalosh, të pengosh ose të vonosh lëvizjen, kalimit apo ecurinë e diçkaje.⁴³ Në kuadër të procedurave të DHS-së, pengimi do të thotë pengimi ose vonimi i punës së zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së.

Elementi mendor

71. Kryesi duhet të ketë vepruar me synim të drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

72. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë dhe dëshirën për përdorimin e forcës ose të kërcënimit të rëndë për ta penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

73. Për synimin e mundshëm, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë se, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të tij, personi zyrtar mund të pengohet në kryerjen e detyrave zyrtareve dhe kryesi e ka miratuar arritjen e këtij rezultati.

⁴³ *Shih OED Online* (Oxford University Press, shtator 2020) <<https://www.oed.com/view/Entry/129983?rskey=vIH75t&result=2#eid>> shikuar më 3 dhjetor 2020.

(b) Pengimi i personave zyrtarë përmes pjesëmarrjes në grup

Elementet materiale

74. Vepra e pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, brenda kuptimit të nenit 401(2) të KPK-së, kryhet (i) përmes pjesëmarrjes në një grup të personave që me veprim të përbashkët (ii) pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

75. Neni 113(12) i KPK-së sqaron se “grupi” konsiston në tre ose më shumë persona. Neni 401(2) i KPK-së nuk i përvijon konturet e veprimit të përbashkët të grupit. Rrjedhimisht, veprimi i përbashkët mund të përfshijë çdo veprimtari që ndërmerret bashkërisht nga anëtarët e grupit.

76. Të gjitha elementet e tjera materiale të kësaj vepre penale janë të njëjta me ato që trajtohen më lart në bazë të nenit 401(1) të KPK-së.⁴⁴

77. Neni 402(3) i KPK-së parashikon dënim më të rëndë kur kryesi është udhëheqësi ose organizatori i grupit.

Elementi mendor

78. Kryesi duhet të ketë vepruar me synim të drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

79. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë dhe dëshirën për të marrë pjesë në një grup në mënyrë që përmes veprimit të përbashkët të pengojë një zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

80. Për synimin eventual, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë se, si pasojë e pjesëmarrjes së tij në grup, personi zyrtar mund të pengohet nga veprimi i

⁴⁴ *Shih më lart* para 69-70 (Pengimi i personave zyrtarë me forcë apo kërcënim të rëndë).

përbashkët në kryerjen e detyrave zyrtareve dhe kryesi është pajtuar me këtë pasojë.

C. FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

81. Në pajtim me nenin 16(3) të Ligjit dhe nenet 17, 28, 31, 32, 33 dhe 35 të KPK-së, Prokurori i Specializuar argumenton këto forma të përgjegjësisë penale: kryerje krimi, tentim, bashkëkryerje, marrëveshje për të kryer një vepër penale, nxitje dhe ndihmë.⁴⁵

82. Elementet objektive të këtyre formave të përgjegjësisë penale parashtrohen në vijim. Sa i takon elementit përkatës subjektiv, për të gjitha këto forma të përgjegjësisë penale nevojitet synim i drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

1. Kryerja

83. Kryerja, brenda kuptimit të nenit 17(1) të KPK-së, kërkon që kryesi të kryejë fizikisht elementet objektive të veprës penale ose të mos veprojë kur sipas ligjit i kërkohet të veprojë.⁴⁶

2. Bashkëkryerja

84. Bashkëkryerja, brenda kuptimit të nenit 31 të KPK-së, kërkon që (i) dy apo më shumë persona së bashku (ii) marrin pjesë në kryerjen e veprës penale ose kontribuojnë thelbësisht në kryerjen e veprës penale në ndonjë mënyrë tjetër.

⁴⁵ Aktakuza, para 36-44, 47-48.

⁴⁶ *Për ngjashmëri*, Kosovë, Gjykata Themelore e Prishtinës, AK e të tjerë, P766/12, Aktgjykim, 17 shtator 2013, f. 199.

85. Për kryerjen e përbashkët nuk është e nevojshme ekzistenca e një marrëveshjeje të mëparshme për kryerjen e veprës penale.⁴⁷ Për të deduktuar ekzistencën e një marrëveshjeje mjafton që veprimet e bashkëkryesve të bashkërendohen gjatë kryerjes së veprës penale.⁴⁸

86. Neni 31 i KPK-së nuk përvijon se çfarë është pjesëmarrja e përbashkët apo se çfarë është kontributi thelbësor në kryerjen e veprës penale. Gjithsesi, secili person që merr pjesë në kryerjen e veprës penale apo që kontribuon thelbësisht në kryerjen e saj duhet të përmbushë një ose më shumë prej elementeve materiale të kësaj vepre penale.⁴⁹

87. Bashkëkryerja nuk mund të aplikohet në lidhje me veprën penale të prezantuar në Pikën 2 (neni 401(2) i KPK-së), sepse elementet materiale të kësaj vepre penale—pengimi i zyrtarit në kryerjen e detyrave zyrtare përmes *veprimit të përbashkët të një grupi personash*—e ka të përfshirë kryerjen e përbashkët. Secili pjesëmarrës i një grupi të tillë vepron si kryes i veçantë.

3. Nxitja

88. Nxitja, brenda kuptimit të nenit 32 të KPK-së, kërkon që kryesi të ushtrojë ndikim psikologjik mbi një person tjetër me qëllim krijimin ose forcimin e vendimit të personit tjetër për ta kryer veprën penale. Një ndikim i tillë, ndër të tjera, mund të marrë formën e inkurajimit, nxitjes apo ushtrimit të presionit ndaj personit për ta kryer veprën penale, si edhe orientimit apo udhëzimit të atij personi në kryerjen e veprës penale.⁵⁰

⁴⁷ Për ngjashmëri, Kosovë, Gjykata Supreme, S.H., PAII-KZII-2/2016, *Aktgjykim*, 20 shtator 2016, para. 58.

⁴⁸ Për ngjashmëri, Kosovë, Gjykata e Apelit, S.G. e të tjerë, PAKR 966/2012, *Aktgjykim*, 11 shtator 2013, para. 74.

⁴⁹ Për ngjashmëri, Kosovë, Gjykata Supreme, S.H., PAII-KZII-2/2016, *Aktgjykim* ("Aktgjykimi S.H."), 20 shtator 2016, para. 58.

⁵⁰ Për ngjashmëri, *Aktgjykimi S.H.*, f. 16-17.

89. Sipas nenit 32(1) të KPK-së, nxitja kërkon që kryesi të nxisë një person tjetër të kryejë vepër penale dhe e ndëshkon nxitësin nëse vepra penale kryhet. Sipas nenit 32(2) të KPK-së, nxitësi mban përgjegjësi edhe nëse është tentuar të kryhet vepra penale e cila nuk është kryer. Sipas nenit 32(3) të KPK-së, nxitësi gjithashtu mban përgjegjësi për nxitjen e një vepre penale të dënueshme me të paktën 5 (pesë) vjet, edhe nëse nuk është tentuar kryerja e kësaj vepre penale.

90. Rrjedhimisht, nxitja sipas nenit 32(3) të KPK-së mund të jetë e dënueshme vetëm në lidhje me veprat penale të paraqitura në Pikat 1-3 dhe 6, duke qenë se për ato parashikohet dënim me burg prej një deri në pesë vjet (neni 401(1) dhe (5) ose 401(2)-(3) dhe (5) i KPK-së), dy deri në dhjetë vjet (neni 387 i KPK-së) dhe gjashtë muaj deri në pesë vjet (neni 392(2)-(3) i KPK-së).

4. Ndihma

91. Ndihma, brenda kuptimit të nenit 33(1) të KPK-së, kërkon që personi ta ndihmojë kryesin në kryerjen e një vepre penale.

92. Sipas nenit 33(2) të KPK-së, kjo ndihmë përfshin, ndër të tjera: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimin paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

5. Marrëveshja për të kryer vepër penale

93. Marrëveshja për të kryer vepër penale, brenda kuptimit të nenit 35 të KPK-së, kërkon që (i) kryesi të merret vesh me një ose më shumë persona të tjera për të

kryer vepër penale dhe (ii) një apo më shumë nga ata persona ndërmerr çfarëdo veprimi të rëndësishëm për kryerjen e veprës penale.

94. Sipas nenit 35(2) të KPK-së, “veprimi i rëndësishëm drejt kryerjes së veprës penale” nuk ka nevojë të jetë veprim penal, por duhet të jetë hap i rëndësishëm përgatitor drejt kryerjes së veprës penale për të cilën personat janë pajtuar që ta kryejnë.

6. Tentativa

95. Tentativa, brenda kuptimit të nenit 28 të KPK-së, kërkon që kryesi të ndërmarrë veprime për kryerjen e veprës penale por veprimi nuk ka përfunduar apo nuk janë përmbushur elementet e veprës së synuar penale.

96. Neni 28 i KPK-së nuk e përvijon më tej se çfarë përbën ndërmarrje veprimi drejt kryerjes së veprës penale. Gjithsesi, një veprim i tillë duhet të shkojë përtej veprimeve përgatitore, të cilat parashikohen më vete në nenin 27 të KPK-së. Si rrjedhim, kryesi bën tentativë për kryerjen e veprës penale nëse qëllimisht ka filluar kryerjen e kësaj vepre, duke përmbushur një ose më shumë prej elementeve materiale të veprës penale.⁵¹

97. Sipas nenit 28(2) të KPK-së, tentativa për të kryer vepër penale ndëshkohet vetëm nëse (i) ajo vepër penale dënohet me tre ose më shumë vjet burgim ose (ii) nëse parashikohet shprehimisht në ligj. Rrjedhimisht, tentativa mund të dënohet vetëm në lidhje me veprat penale të paraqitura në Pikat 1-4 dhe 6, duke qenë se vepra penale e paraqitur në Pikën 5 parashikon dënim me burgim jo më shumë se një vit dhe nuk parashikohet shprehimisht dënimi i tentativës për kryerje.

⁵¹ *Për ngjashmëri*, Kosovë, Gjykata Themelore e Prizrenit, A.Ç. e të tjerë, 410/13, *Aktgjykim*, 14 prill 2016, f. 150-152.

VI. AKUZAT

98. Përpara shqyrtimit të materialit mbështetës në lidhje me secilën akuzë dhe nxjerrjes së konstatimit nëse është vërtetuar një dyshim i bazuar mirë kundër të dyshuarve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja i ka përmbushur kriteret e rregullës 86(3) të Rregullores përmes dorëzimit të: (i) një aktakuze; (ii) materialit provues që mbështet faktet mbi të cilat janë ngritur akuzat; dhe (iii) një përmbledhjeje që tregon lidhjen e secilës provë të materialit provues me secilën akuzë.

A. KRIMET E PARAQITURA NË AKTAKUZË

1. Shkelja e fshehtësisë së procedurës – informacioni i mbrojtur (Pika 5)

99. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe disa të tjerë zbuluan, pa autorizim, dokumente konfidenciale dhe jopublike që u përkisnin hetimeve të ZPS-së.⁵²

100. Sa u takon elementeve materiale të veprës penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës bën të ditur se, në konferencat për shtyp të mbajtura më 7,⁵³ 16⁵⁴ dhe 22⁵⁵ shtator 2020 (“tri konferencat për shtyp”)

⁵² Aktakuza, para 23, 33, 48.

⁵³ 081344-01-TR-ET (Konferencë për shtyp e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”) më 7 shtator 2020).

⁵⁴ 081344-02-TR-ET (Konferencë për shtyp e OVL-UÇK-së më 16 shtator 2020).

⁵⁵ 081344-03-TR-ET (Konferencë për shtyp e OVL-UÇK-së më 22 shtator 2020).

dhe në transmetime televizive më 7,⁵⁶ 8,⁵⁷ 9,⁵⁸ 11,⁵⁹ 17,⁶⁰ 20,⁶¹ 22⁶² dhe 25⁶³ shtator 2020, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme të kryer midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, përfshirë edhe me anë të deklaratave në mediat sociale,⁶⁴ të dyshuarit dhe të tjerë, përfshirë Faton Klinakun (“z. Klinaku”) dhe anëtarë të tjerë të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”) (bashkërisht të quajtur “ndihmësit”),⁶⁵ drejtpërdrejt zbuluan dhe/ose përmendën zbulimin e mëparshëm ose të parashikuar të informacionit të mbrojtur. Ky informacion ndodhej në tri paketa, që ZPS-ja i sekuestroi më 8, 17 dhe 22 shtator 2020 në mjediset e OVL-UÇK-së⁶⁶ dhe përfshinte: (i) kërkesat e TFHS-së për ndihmë drejtuar autoriteteve kompetente serbe midis vitit 2013 dhe

⁵⁶ 081358-01-TR-ET (Program televiziv me z. Gucati në RTK1 më 7 shtator 2020).

⁵⁷ 081931-02-TR-ET (Program televiziv me z. Klinaku në RTK më 8 shtator 2020).

⁵⁸ 081991-01-TR-ET (Program televiziv me z. Haradinaj në RTK më 9 shtator 2020).

⁵⁹ 081358-02-TR-ET (Program televiziv me z. Haradinaj në RTK1 më 11 shtator 2020).

⁶⁰ 081347-01-TR-ET (Program televiziv me z. Gucati dhe Tomë Gashin (“z. Gashi”) në Kanal10 më 17 shtator 2020); 081355-02-TR-ET (Program televiziv me z. Haradinaj në T7 më 17 shtator 2020); 082106-06-TR-ET dhe 082106-07-TR-ET (Intervista me z. Haradinaj më 17 shtator 2020).

⁶¹ 081355-04-TR-ET Rishikuar (Program televiziv me z. Haradinaj në Kanalën e Parë më 20 shtator 2020).

⁶² 082106-01-TR-ET (Intervistë me z. Gucati në KTV më 22 shtator 2020); 082106-03-TR-ET (Program televiziv me z. Haradinaj në RTK më 22 shtator 2020); 081358-03-TR-ET Rishikuar (Program televiziv me z. Haradinaj në T7 më 22 shtator 2020).

⁶³ 081991-03-TR-ET Rishikuar (Intervistë me z. Haradinaj më 25 shtator 2020).

⁶⁴ SPOE00220800-00220800-ET (8 shtator 2020, postim në *Facebook* i z. Haradinaj); 081987-081988-ET (21 shtator 2020, postim në *Facebook* i z. Gucati).

⁶⁵ 081344-01-TR-ET, f. 1, 8-9; 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 4; 081358-01-TR-ET, f. 5-6, 8-9; 081931-02-TR-ET, f. 1; 081991-01-TR-ET, f. 5; 081344-03-TR-ET Rishikuar, f. 9; 082106-01-TR-ET, f. 2; 082106-03-TR-ET, f. 3-4; 081355-02-TR-ET, f. 29; 082106-07-TR-ET, f. 1; 081347-01-TR-ET, f. 14; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 3; 081991-03-TR-ET Rishikuar.

⁶⁶ KSC-BC-2020-07, raporte të ZPS-së: F00008/RED, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Publik i Raportit të Prokurorisë në pajtim me Vendimin KSC-BC-2018-01/F00121* (“F00008/RED”), 14 tetor 2020, publik (lidhur me dokumentet e sekuestruara më 8 shtator 2020); F00028/RED, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Publik i Raportit të Prokurorisë në pajtim me Vendimin KSC-BC-2018-01/F00123* (“F00028/RED”), 14 tetor 2020, publik (lidhur me dokumentet e sekuestruara më 17 shtator 2020); dhe F00010/RED, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Publik i Njoftimit të Prokurorisë dhe Kërkesës në lidhje me të* (“F00010/RED”), 14 tetor 2020, publik (lidhur me dokumentet e sekuestruara më 22 shtator 2020); 084015-084026, para 5-12 (ku identifikohen si “Paketa 1” dokumentet e sekuestruara më 8 shtator 2020), 19-27 (ku identifikohen si “Paketa 2” dokumentet e sekuestruara më 17 shtator 2020) dhe 28-35 (ku identifikohen si “Paketa 3” dokumentet e sekuestruara më 22 shtator 2020) (084015-084016, 084018-084021).

2015, me shtojca konfidenciale (Paketat 1 dhe 2);⁶⁷ (ii) [REDAKTUAR] konfidencial [REDAKTUAR] që përmbante një analizë të provave të disponueshme dhe dispozitave ligjore përkatëse [REDAKTUAR] (Paketa 3);⁶⁸ dhe (iii) përmendje të dokumenteve dhe informacionit që organizata ndërkombëtare dhe subjekte të tjera i kishin dhënë ZPS-së e të cilat ishin objekt konfidencialiteti dhe kufizimesh mbi përdorimin (Paketa 3).⁶⁹ Informacioni i zbuluar ka të bëjë me hetimet e ZPS-së, përfshirë bashkëpunimin me një shtet të tretë dhe [REDAKTUAR], të cilat ishin shënuar ose përmendeshin të gjitha si konfidenciale nga ana e ZPS-së.⁷⁰

101. Materiali mbështetës më tej bën të ditur se të dyshuarit dhe ndihmësit e zbuluan informacionin e mbrojtur si vijon. Së pari, në tri konferencat për shtyp, të dyshuarit dhe ndihmësit afishuan dhe/ose u treguan kopje të informacionit të mbrojtur përfaqësuesve të shtypit ë pranishëm,⁷¹ ua lejuan ta lexonin, ta filmonin ose ta fotografonin përmbajtjen⁷² dhe i ftuan të bënin sa kopje të donin.⁷³ Së dyti, të dyshuarit dhe ndihmësit u shpërndanë kopje të tjera të informacionit të mbrojtur përfaqësuesve të shtypit dhe të tjerëve.⁷⁴ Së treti, të dyshuarit dhe ndihmësit përmendën përmbajtjen e një pjese të informacionit të mbrojtur gjatë tri konferencave për shtyp,⁷⁵ gjatë aktiviteteve të tjera të transmetuara⁷⁶ dhe përmes mediave sociale.⁷⁷ Të dyshuarit dhe ndihmësit i kryen këto veprime pa pasur

⁶⁷ 084015-084026, para 7-8, 22-25 (084015-084016, 084018-084019).

⁶⁸ 084015-084026, para. 29 (084019-084020).

⁶⁹ 084015-084026, para. 34 (084020).

⁷⁰ 084015-084026, para 8, 23-25, 35 (084016, 084018-084019, 084021).

⁷¹ 081344-01-TR-ET, f. 1-2, 11-12; Video 081344-01, 01:12-01:30; 081344-02-TR-ET, f. 1-2, 11; Video 081344-02, 00:01-01:11; 081344-03-TR-ET Rishikuar f. 2, 22; Video 081344-03, 00:22-01:59.

⁷² 081344-01-TR-ET, f. 10; 081344-02-TR-ET, f. 11; 081344-03-TR-ET Rishikuar, f. 2, 9, 12, 22; Video 081344-03, 00:22-01:59; 082136-01, 26:45-27:18.

⁷³ 081344-01-TR-ET, f. 11; 081344-02-TR-ET, f. 8; 081344-03-TR-ET Rishikuar, f. 8, 12; 081931-02-TR-ET, f. 1.

⁷⁴ 081344-03-TR-ET Rishikuar, f. 10; 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 3; 081358-01-TR-ET, f. 5-6, 8-9; SPOE00220800-SPOE00220800-ET, f. 1 (SPOE00220800); 081991-01-TR-ET, f. 5-6.

⁷⁵ 081344-01-TR-ET, f. 3-5; 081344-02-TR-ET, f. 2, 4-5; 081344-03-TR-ET, f. 2-4.

⁷⁶ 081358-01-TR-ET, f. 5, 7, 9-12; 081358-03-TR-ET, f. 30; 082106-01-TR-ET, f. 9-10; 082106-06-TR-ET Rishikuar, f. 2.

⁷⁷ 081987-081988-ET, f. 1-2 (081987-081988).

autorizim për ta zbuluar informacionin e mbrojtur dhe pavarësisht se në mënyrë të përsëritur u ishte dhënë urdhër të mos kopjonin në asnjë lloj mënyre dhe të mos shpërndanin më tej me asnjë mjet komunikimi këtë informacion.⁷⁸

102. Sa i takon elementit mendor të veprës penale, materiali mbështetës bën të ditur se të dyshuarit dhe ndihmësit e zbuluan informacionin e lartpërmendur në mënyrë të qëllimshme. Në veçanti, të dyshuarit dhe ndihmësit: (i) i shqyrtuan dokumentet e marra dhe kishin mundësi të vërenin shenjat që tregonin se ishin konfidenciale;⁷⁹ (ii) pranuan publikisht se dokumentet ishin konfidenciale;⁸⁰ (iii) i mbrojtën publikisht veprimet e veta,⁸¹ duke pranuar njëkohësisht se zbulimi ndalohej me ligj dhe/ose mund t'i ngarkonte me përgjegjësi penale;⁸² dhe (iv) premtuan se do të vijonin me zbulimin e dokumenteve të marra në të ardhmen,⁸³ edhe pasi u ishin dorëzuar urdhrat e Gjykatësit të Vetëm dhe të ZPS-së për të mos e bërë një gjë të tillë.⁸⁴ Kjo dëshmon se të dyshuarit dhe ndihmësit vepruan me dijeninë dhe dëshirën për ta zbuluar pa autorizim informacionin e

⁷⁸ KSC-BC-2020-07, F00005, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim Urgjent që Autorizon Sekuestrim* ("F00005"), 7 shtator 2020, publik, para 22(c), 25; F00007, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim që Autorizon Sekuestrim* ("F00007"), 17 shtator 2020, publik, para 22(c), 25; F00010/RED, para. 4.

⁷⁹ 081344-01-TR-ET, f. 1 (z. Gucati përmend shqyrtimin e kryer nga z. Haradinaj, z. Klinaku dhe të tjerë), 5-6, 10 (z. Haradinaj përmend shënimet "konfidenciale" dhe "top sekrete"); 081344-02-TR-ET, f. 5-7 (z. Haradinaj përmend shënimet "top sekrete" dhe informacione të tjera "sekrete" që përmbajnë dokumentet); 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 3-4, 8, 12 (z. Haradinaj përmend se i ka parë dokumentet).
⁸⁰ 081344-01-TR-ET, f. 5-6, 10 (z. Haradinaj); 081344-02-TR-ET, f. 5-7 (z. Haradinaj); 081355-02-TR-ET, f. 19, 21 (z. Haradinaj); 082106-07-TR-ET, f. 1 (z. Haradinaj); 081987-081988-ET, f. 1-2 (z. Gucati); 081931-02-TR-ET, f. 1 (z. Klinaku); 081355-03-TR-ET, f. 2 (z. Gashi).

⁸¹ 081358-01-TR-ET, f. 8 (z. Gucati); 082106-07-TR-ET, f. 1 (z. Haradinaj); 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 1, 13 (z. Haradinaj); SPOE00220800-SPOE00220800-ET, f. 1 (z. Haradinaj).

⁸² 081347-01-TR-ET, f. 14 (z. Gucati), 16 (z. Gashi); 082106-01-TR-ET, f. 1-2, 12 (z. Gucati); 081987-081988-ET, f. 2 (z. Gucati); 081344-03-TR-ET, f. 19-21 (z. Haradinaj); 081991-01-TR-ET, f. 7-8 (z. Haradinaj); 081991-02-TR-ET, f. 1-2 (z. Haradinaj); 082106-03-TR-ET, f. 21 (z. Haradinaj); 081931-02-TR-ET, f. 1 (z. Klinaku); 081355-03-TR-ET, f. 3 (z. Gashi).

⁸³ 081347-01-TR-ET, f. 3 (z. Gucati); 082106-01-TR-ET, f. 11 (z. Gucati); 081344-02-TR-ET, f. 9 (z. Haradinaj); 081344-03-TR-ET Rishikuar, f. 6 (z. Haradinaj); 081355-02-TR-ET, f. 15 (z. Haradinaj); 081358-02-TR-ET, f. 1, 4 (z. Haradinaj); 081991-01-TR-ET, f. 7 (z. Haradinaj); 081991-03-TR-ET Rishikuar, f. 4-5 (z. Haradinaj); 082106-07-TR-ET, f. 2 (z. Haradinaj).

⁸⁴ KSC-BC-2020-07, F00008/RED, para 2-3; F00028/RED, para 2, 5; F00010/RED, para. 4. *Shih edhe* 081347-01-TR-ET, f. 14 (z. Gucati); SPOE00222202-SPOE00222202 (9 shtator 2020, postim në Facebook i z. Haradinaj).

lartpërmendur ose, të paktën, vepruan me dijeninë se, si pasojë e veprimeve të tyre, informacioni i lartpërmendur mund të zbulohet pa autorizim dhe ata u pajtuan me këtë pasojë.

103. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e sipërpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se, së paku midis datave 7 dhe 25 shtator 2020 të dyshuarit dhe ndihmësit kryen veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së dhe të nenit 15(2) të Ligjit.

2. Shkelja e fshehtësisë së procedurës – personat e mbrojtur (Pika 6)

104. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se së paku midis datave 7 dhe 25 shtator 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit zbuluan ose tentuan të zbulonin pa autorizim identitetin dhe të dhënat personale të dëshmitarëve të mbrojtur nga DHS/ZPS-ja ose nga vendime në procese të mëparshme penale në Kosovë.⁸⁵ ZPS-ja pretendon më tej se ky zbulim i paautorizuar solli pasojat të rrezikshme për dëshmitarët dhe i pengoi rëndë hetimet e ZPS-së.⁸⁶

105. Sa u takon elementeve materiale të veprës penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës bën të ditur se, në tri konferencat për shtyp dhe në transmetime televizive të tjera më 7,⁸⁷ 17⁸⁸ dhe 22⁸⁹ shtator 2020, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme të bërë midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, përfshirë edhe në deklaratat në mediat sociale, të dyshuarit dhe ndihmësit zbuluan identitetin dhe/ose të dhënat personale të personave të mbrojtur. Konkretisht, u zbuluan këto informacione: (i) emrat dhe/ose të dhënat

⁸⁵ Aktakuza, para 34, 48; Përmbledhja e Detajuar, f. 45-46.

⁸⁶ Aktakuza, para 35, 48.

⁸⁷ 081358-01-TR-ET (program televiziv me z. Gucati në RTK1 më 7 shtator 2020).

⁸⁸ 082106-06-TR-ET (intervistë me z. Haradinaj më 17 shtator 2020).

⁸⁹ 081358-03-TR-ET Rishikuar (program televiziv me z. Haradinaj në T7 më 22 shtator 2020).

personale [REDAKTUAR] (Paketat 1-3);⁹⁰ (ii) identitetet [REDAKTUAR] (Paketa 3);⁹¹ (iii) emrat, [REDAKTUAR] (Paketa 3);⁹² dhe (iv) përmendja [REDAKTUAR] që ZPS-së i ishin dhënë nga organizata ndërkombëtare dhe subjekte të tjera dhe të cilat ishin objekt konfidencialiteti dhe kufizimesh në përdorim (Paketa 3).⁹³

106. Sa i takon mënyrës me të cilën u zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të personave të mbrojtur, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme lidhur me zbulimin e paautorizuar të informacionit të mbrojtur.⁹⁴ Në veçanti, materiali mbështetës bën të ditur se të dyshuarit dhe ndihmësit përmendën emrin, funksionin ose të dhëna të tjera mundësisht identifikuese të personave të mbrojtur ose i informuan të tjerët se të dhëna të tilla mund të gjendeshin në dokumentet e zbuluara gjatë tri konferencave për shtyp,⁹⁵ gjatë transmetimeve të tjera⁹⁶ dhe përmes mediave sociale.⁹⁷ Të dyshuarit dhe ndihmësit i ndërmorën këto veprime pa asnjë autorizim për zbulimin e identitetit dhe/ose të dhënave personale të personave të mbrojtur dhe pavarësisht se në mënyrë të përsëritur u ishte dhënë urdhër të mos kopjonin në asnjë lloj mënyre dhe të mos shpërndanin më tej me asnjë mjet komunikimi këtë informacion .⁹⁸

107. Sa i takon rrethanës rënduese të veprës penale të parashikuar në nenin 392(3) të KPK-së, materiali mbështetës bën të ditur se zbulimi i identitetit dhe/ose të dhënave personale të personave të mbrojtur shkaktoi pasoja të rrezikshme dhe i pengoi rëndë hetimet e ZPS-së. Në veçanti, me dhjetëra persona të mbrojtur u ndien të shqetësuar, të stresuar, të rrezikuar, të kërcënuar dhe/ose të frikësuar për

⁹⁰ 084015-084026, para 9-12, 23, 25-27, 30-31 (084016, 084018-084020).

⁹¹ 084015-084026, para. 32 (084020).

⁹² 084015-084026, para. 33 (084020).

⁹³ 084015-084026, para. 34 (084020).

⁹⁴ *Shih më lart* para 100-101 (Pika 5).

⁹⁵ 081344-01-TR-ET, f. 3-5; 081344-02-TR-ET, f. 2, 4-5; 081344-03-TR-ET, f. 4.

⁹⁶ 081358-01-TR-ET, f. 6-7, 9-10; 082106-06-TR-ET Rishikuar, f. 2; 081358-03-TR-ET, f. 30.

⁹⁷ 081987-081988-ET, f. 1-2 (081987-081988).

⁹⁸ KSC-BC-2020-07, F00005, para 22(c), 25; F00007, para 22(c), 25; F00010/RED, para. 4.

shkak të këtij zbulimi të paautorizuar.⁹⁹ Njëri prej tyre u largua nga shtëpia dhe pastaj u largua nga Kosova.¹⁰⁰ Një tjetër person i mbrojtur u fsheh në shtëpi i frikësuar për sigurinë e tij.¹⁰¹ Një person mori masa për të rritur sigurinë e fëmijëve pasi mësoi se i ishte zbuluar emri.¹⁰² Një tjetër person i mbrojtur ndihej se, pasi iu zbulua emri, po ia shihnin ndryshe familjen dhe biznesi i tij humbi klientë.¹⁰³ Disa persona të mbrojtur u ndien se zbulimi i emrave ua vinte në rrezik familjen dhe kjo çoi në izolimin e tyre.¹⁰⁴ Për më tepër dhe si pasojë e sa më lart, hetimet e ZPS-së u penguan rëndë dhe/ose u vonuan, duke pasur parasysh se: (i) ZPS-së iu desh të devijonte dhe të përdorte një sasi të konsiderueshme burimesh shtesë për komunikimin me personat e mbrojtur dhe për problemet rezultuese të sigurisë pas çdo zbulimi të paautorizuar në shtator 2020;¹⁰⁵ dhe (ii) aftësia e ZPS-së për të hetuar dhe proceduar penalisht me efektivitet krime, përfshirë edhe mbledhjen e provave përkatëse, u cenua ndjeshëm.

108. Sa i takon elementit mendor të veprës penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme lidhur me zbulimin e qëllimshëm të informacionit të mbrojtur nga ana e të dyshuarve dhe e ndihmësve.¹⁰⁶ Gjithashtu, materiali mbështetës bën të ditur se të dyshuarit dhe ndihmësit i ftuan në mënyrë të përsëritur përfaqësuesit e shtypit t'i lexonin emrat e personave të mbrojtur në dokumentet e zbuluara¹⁰⁷ dhe e dinin dhe e pranuan publikisht se publikimi i identiteteve të personave të mbrojtur ndalohej me ligj.¹⁰⁸

⁹⁹ 084008-084010, para. 6 (084008).

¹⁰⁰ 084008-084010, para. 7 (084009).

¹⁰¹ 084008-084010, para. 8 (084009).

¹⁰² 084008-084010, para. 11 (084009).

¹⁰³ 084008-084010, para. 12 (084009).

¹⁰⁴ 084008-084010, para 9-12 (084009).

¹⁰⁵ 084008-084010, para. 13 (084009).

¹⁰⁶ *Shih më lart* para. 102 (Pika 5).

¹⁰⁷ 081344-01-TR-ET, f. 10; 081344-03-TR-ET, f. 22.

¹⁰⁸ 081344-03-TR-ET, f. 1 (z. Gucati); 081987-081988-ET, f. 1 (081987) (z. Gucati); 082106-01-TR-ET, f. 1-2 (z. Gucati); 081344-01-TR-ET, f. 3 (z. Haradinaj); 081344-02-TR-ET, f. 7 (z. Haradinaj); 081931-02-TR-ET, f. 1 (z. Klinaku); 081347-01-TR-ET, f. 4-5, 7-8, 12 (z. Gashi në praninë e z. Gucati).

Kjo dëshmon se të dyshuarit dhe ndihmësit vepruan me dijeninë dhe dëshirën për të zbuluar pa autorizim identitetet dhe/ose të dhënat personale të personave të mbrojtur ose, të paktën, vepruan me dijeninë se, si pasojë e veprimeve të tyre, ky informacion mund të zbulohet pa autorizim dhe ata u pajtuan me këtë pasojë.

109. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e sipërpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se së paku midis datave 7 dhe 25 shtator 2020 të dyshuarit dhe ndihmësit kryen veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së dhe të nenit 15(2) të Ligjit.

3. Hakmarrje (Pika 4)

110. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit ndërmorën ose tentuan të ndërmerrnin veprime të dëmshme kundër dëshmitarëve me synimin e hakmarrjes për dhënien ZPS-së të informacionit të besueshëm në lidhje me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprave penale.¹⁰⁹

111. Sa u takon elementeve materiale të veprës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit ndërmorën veprime të dëmshme kundër dhënësve të informacionit në mënyrën e mëposhtme. Së pari, zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të [REDAKTUAR] personave të mbrojtur, përfshirë edhe ata që i kanë dhënë informacion ZPS-së, sipas mënyrave të përshkruara në Pikën 6.¹¹⁰ Së dyti, denigruan dhe akuzuan dhënësit e informacionit. Në veçanti, zoti Gucati i akuzoi këta persona se informacionet i kishin dhënë për të fituar azil

¹⁰⁹ Aktakuza, para 31, 48.

¹¹⁰ *Shih më lart* para. 106 (Pika 6).

jashtë vendit¹¹¹ dhe më tej i përshkroi ata si “shqipfolës”¹¹² dhe si “tradhtarë” që gënjejnë.¹¹³ Zoti Haradinaj i quajti dhënësit e informacionit “kriminelë, gjakpirës”¹¹⁴ dhe spiunë që kishin tradhtuar popullin e vet.¹¹⁵ Ai tha:

Materiali i parë që për me kallxu vetëm kështu. O qyqona, u budallë, o spiuna të lind, o spiuna, mos mendoni që ju mbron kush, veç po ju shfrytëzon, se kurrë në botë nuk mbahet mend që e ka mbrojt dikush spiunin mbasi e ka shfrytëzu. Përkundrazi, o e ka vra, o e ka diskretitu, o e ka bo kare. Tash të presësh ti, ta tradhëtosh popullin tënd, ushtrinë tënde, të rrejsh, të shpifësh, me fakte të armikut?¹¹⁶

Këto veprime ishin të dëmshme sepse të dyshuarit dhe ndihmësit ndërhyjnë, sipas rastit, në sigurinë, mjetet e jetesës, mirëqenien dhe privatësinë të dhënësve të informacionit dhe familjeve të tyre.¹¹⁷ Në veçanti, siç është përshkruar më lart, personat e mbrojtur u larguan nga Kosova,¹¹⁸ u fshehën brenda shtëpisë,¹¹⁹ humbën klientët e biznesit¹²⁰ ose u ndien të izoluar apo të rrezikuar.¹²¹

112. Sa i takon elementit mendor të veprës penale, materiali mbështetës tregon se të dyshuarit dhe ndihmësit qëllimisht ndërmorën veprime dëmtuese kundër dhënësve të informacionit. Në veçanti, komentet e lartpërmendura¹²² dhe shpërndarja e kopjeve të shumta të informacionit të mbrojtur,¹²³ krahas deklaratave ku pasqyrohej dëshira e të dyshuarve që identiteti i personave të tillë të njihej gjerësisht,¹²⁴ dëshmojnë se të dyshuarit dhe ndihmësit ndërmorën veprime të dëmshme me dijeninë dhe dëshirën për t’u hakmarrë në veçanti kundër

¹¹¹ 081358-01-TR-ET, f. 10-11.

¹¹² 081358-01-TR-ET, f. 11-12.

¹¹³ 081358-01-TR-ET, f. 12.

¹¹⁴ 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 2.

¹¹⁵ 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 10.

¹¹⁶ 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 10.

¹¹⁷ *Shih më lart* para. 107 (Pika 6); 084008-084010, para 6-12 (084008-084009); 081344-01-TR-ET, f. 8-9.

¹¹⁸ 084008-084010, para. 7 (084009).

¹¹⁹ 084008-084010, para. 8 (084009).

¹²⁰ 084008-084010, para. 12 (084009).

¹²¹ 084008-084010, para 9-12 (084009).

¹²² *Shih më lart* para. 111 (Pika 4).

¹²³ *Shih më lart* para 101 (Pika 5) dhe 106 (Pika 6).

¹²⁴ 081344-01-TR-ET, f. 8-9 (z. Haradinaj); 081358-01-TR-ET, f. 8 (z. Gucati).

dhënësve të informacionit ose, më së paku, ndërmorën veprime të dëmshme me dijeninë se, si pasojë e këtyre veprimeve, këta persona do të pësonin hakmarrje për shkak të dhënies së informacioneve ZPS-së dhe u pajtuan me këtë pasojë.

113. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e sipërpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se, së paku midis datave 7 dhe 25 shtator 2020 të dyshuarit dhe ndihmësit kryen veprën penale të hakmarrjes brenda kuptimit të nenit 388(1) të KPK-së dhe nenit 15(2) të Ligjit.

4. Frikësimi gjatë procedurës penale (Pika 3)

114. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit përdorën forcë, kërcënime të rënda dhe/ose mënyra të tjera detyrimi për të nxitur ose për të tentuar të nxisin dëshmitarët që të mos japin deklaratë, apo të japin deklaratë të rreme, ose ndryshe të mos i japin informacion të vërtetë ZPS-së dhe/ose DHS-së.¹²⁵

115. Sa u takon elementeve materiale të veprës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit përdorën kërcënime të rënda për t'i nxitur dhënësit e mundshëm të informacionit të mos i jepnin informacione ose t'i jepnin informacione të rreme ZPS-së dhe/ose DHS-së. Së pari, ata zbuluan identitetin dhe/ose të dhënat personale të [REDAKTUAR] personave të mbrojtur, përfshirë edhe ata që i kishin dhënë informacione ZPS-së, siç përshkruhet në Pikën 6.¹²⁶ Së dyti, ata kërkuan të siguronin shpërndarjen e gjerë të informacionit të mbrojtur, duke shpërndarë kopje të shumta të tij¹²⁷ dhe duke ushtruar në mënyrë të

¹²⁵ Aktakuza, para 29-30, 48.

¹²⁶ *Shih më lart* para. 106 (Pika 6).

¹²⁷ *Shih më lart* para 101 (Pika 5) dhe 106 (Pika 6).

përsëritur presion mbi mediat që këto ta publikonin këtë informacion,¹²⁸ gjithë duke e pranuar se një zbulim i tillë ndalohej me ligj.¹²⁹ Së treti, ata i denigruan dhe akuzuan dhënësit e informacionit,¹³⁰ duke dhënë sinjale të qarta se çdo dhënës i mundshëm informacioni që bën të njëjtën gjë do të zbulohet dhe do të përballet me pasoja. Në veçanti, zoti Gucati deklaroi se ai ishte befasuar se sa shumë njerëz, të cilëve ai dhe të tjerë u kishin besuar dhe i kishin respektuar, kishin “bashkëpunuar” me DHS-në.¹³¹ Ai e pranonte edhe se “mund të ndodhin gjëra” për shkak të zbulimit të emrave, gjithë duke mos pranuar përgjegjësinë për zbulimin e dokumenteve.¹³² Zoti Haradinaj deklaroi se i njihte të gjithë personat e përmendur në dokumente¹³³ dhe se ai dhe të tjerë po ua nxirrnin emrat dhe të dhënat e tjera dëshmitarëve “që të dihet”.¹³⁴ Zoti Haradinaj gjithashtu deklaroi se zbulimi i paketës së parë të dokumenteve kishte për synim që ta bënte të qartë që dëshmitarët nuk mund të prisnin mbrojtje, duke shtuar se disa prej këtyre personave ishin vlarë, diskredituar apo nënçmuar.¹³⁵ Së katërti, duke ndërhyrë në sigurinë, mjetet e jetesës, mirëqenien dhe privatësinë e dhënësve të informacionit dhe të familjeve të tyre,¹³⁶ të dyshuarit dhe ndihmësit dhanë sinjale të qarta se çdo dhënës i mundshëm i informacionit do të kishte pasoja të ngjashme. Nga ana tjetër, materiali mbështetës nuk sugjeron që të dyshuarit dhe ndihmësit të kenë përdorur forcë fizike apo ndonjë formë tjetër detyrimi, përveç kërcënimeve të rënda, për kryerjen e veprës penale.

¹²⁸ 081344-01-TR-ET, f. 11, 13; 081344-02-TR-ET, f. 1; 081344-03-TR-ET Rishikuar, f. 2, 4, 9, 12; 082106-06-TR-ET, f. 3; 082106-03-TR-ET, f. 20; 081355-02-TR-ET, f. 7, 16; 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 8-9; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 4.

¹²⁹ *Shih më lart* poshtëshënimi. 82 (Pika 5).

¹³⁰ *Shih më lart* para. 111 (Pika 4).

¹³¹ 081358-01-TR-ET, f. 9-11.

¹³² 081358-01-TR-ET, f. 8.

¹³³ 081355-04-TR-ET, f. 4.

¹³⁴ 081344-01-TR-ET, f. 9.

¹³⁵ 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 10.

¹³⁶ *Shih më lart* para 107 (Pika 6) dhe 111 (Pika 4).

116. Sa i takon elementit mendor, materiali mbështetës tregon mënyrën e qëllimshme me të cilën të dyshuarit dhe ndihmësit i kanë kryer kërcënimet e rënda për t'i nxitur dhënësit e mundshëm të informacionit që mos t'i japin informacione apo që t'i japin informacione të rreme ZPS-së dhe/ose DHS-së. Në veçanti, përpjekjet e tyre për të siguruar shpërndarjen e gjerë të informacionit të mbrojtur,¹³⁷ shoqëruar me deklaratat dhe komentet e lartpërmendura¹³⁸ dhe deklaratat e përsëritura se priteshin zbulime të tjera¹³⁹ dëshmojnë se të dyshuarit dhe ndihmësit përdorën frikësim përmes kërcënimeve të rënda me dijeninë dhe dëshirën për ta kryer këtë veprë penale ose, më së paku, se vepruan me dijeninë se, si pasojë e veprimeve të tyre, dhënës të mundshëm të informacionit mund të nxiteshin të mos jepnin informacione ose të jenin informacione të rreme dhe se ata u pajtuan me këtë pasojë.

117. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e sipërpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë që midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit kryen veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale brenda kuptimit të nenit 387 të KPK-së dhe nenit 15(2) të Ligjit përmes kërcënimit të rëndë.

¹³⁷ *Shih më lart* para 101 (Pika 5), 106 (Pika 6), 112 (Pika 4) dhe 115 (Pika 3).

¹³⁸ *Shih më lart* para 111 (Pika 4) dhe 115 (Pika 3).

¹³⁹ 081347-01-TR-ET, f. 11 (z. Gucati: "Kur e ka dorëzuar paketën me materiale thotë që "brenda ditëve në vijim do të sjelli materiale të tjera"."); 082106-01-TR-ET, f. 12 (z. Gucati: "Ne edhe sot ju kemi dërguar edhe më herët, në se ai zotnia që i ka pru dosjet sot, ai ka thon se un do të bie CD me materiale. CD. Une sot ju kam thon, kapeni ato për veshi, mos e leni me u ngjit shkallës, se në se i bin CD, une do ti publikoj."); 081344-02-TR-ET, f. 14-15 (z. Haradinaj: "Apet ka thanë kam me i pru. [...] Edhe sot tha, apet kam me i pru."); 081344-03-TR-ET, f. 3 (z. Haradinaj: "por kanë lanë porosinë se "tash e mas do t'ju sjell CD, s'ju vyjn më dosje"."); 081355-04-TR-ET-Rishikuar, f. 10 (z. Haradinaj: "100 për qind ka me pru diçka, dhe më ekstra.").

5. Pengimi i personave zyrtarë – me anë të kërcënimit të rëndë (Pika 1)

118. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit, me anë të forcës ose të kërcënimit të rëndë, penguan ose tentuan të pengonin procedurat e Dhomave të Specializuara, përfshirë hetimet e ZPS-së.¹⁴⁰

119. Sa u takon elementeve materiale të veprës penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit penguan, me anë të kërcënimit të rëndë, punën e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së në kuadër të procedurave të DHS-së. Së pari, ata zbuluan informacion të mbrojtur, si edhe identitetet dhe/ose të dhënat personale të [REDAKTUAR] personave të mbrojtur, përfshirë edhe të atyre që i kishin dhënë informacion ZPS-së, siç përshkruhet në Pikat 5-6.¹⁴¹ Së dyti, ata u hakmorën kundër dhënësve të informacionit, siç përshkruhet në Pikën 4.¹⁴² Së treti, ata frikësuan dhënësit e mundshëm të informacionit, siç përshkruhet në Pikën 3.¹⁴³ Si pasojë e veprimeve të lartpërmendura, sidomos për shkak të ndikimit (të mundshëm) të dëshmitarët dhe të tjerët që bashkëpunojnë me ZPS-në dhe/ose DHS-në, ata e penguan dhe/ose e vonuan punën e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së, në veçanti të prokurorëve të ZPS-së, të hetuesve dhe të punonjësve të DHS-së, në kuadër të procedurave të DHS-së. Kjo u arrit me këto mënyra: (i) gjithnjë e më shumë, pas çdo zbulimi të paautorizuar në shtator 2020, ZPS-së iu desh të devijonte dhe të përdorte një sasi të konsiderueshme burimesh shtesë për komunikimin me personat e mbrojtur dhe për çështje të lidhura të sigurisë;¹⁴⁴ dhe (ii) aftësia e ZPS-së për të hetuar dhe proceduar me efektivitet krime, përfshirë edhe marrjen e provave përkatëse, u cenua ndjeshëm. Megjithatë, materiali

¹⁴⁰ Aktakuza, para 4, 25-28, 48.

¹⁴¹ *Shih më lart* para 100-103 (Pika 5) dhe 105-109 (Pika 6).

¹⁴² *Shih më lart* para 111-113 (Pika 4).

¹⁴³ *Shih më lart* para 115-117 (Pika 3).

¹⁴⁴ 084008-084010, para. 13 (084009).

mbështetës nuk sugjeron që të dyshuarit dhe ndihmësit të kenë përdorur drejtpërdrejt ose tërthorazi forcën fizike, përveç kërcënimeve të rënda, për kryerjen e veprës.

120. Sa i takon elementit mendor të veprës penale, materiali mbështetës tregon se të dyshuarit dhe ndihmësit në mënyrë të qëllimshme përdorën kërcënimin e rëndë për të penguar punën e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së në kuadër të procedurave të DHS-së. Në veçanti, të dyshuarit dhe ndihmësit zbuluan informacion të mbrojtur, përfshirë identitetet dhe/ose të dhënat personale të [REDAKTUAR] personave të mbrojtur¹⁴⁵ dhe premtuan se do të vijonin me zbulimin e një informacioni të tillë që do të merrnin në të ardhmen,¹⁴⁶ edhe pasi u qenë dorëzuar urdhrat e Gjykatësit të Vetëm dhe të ZPS-së për të mos e bërë një gjë të tillë.¹⁴⁷ Për më tepër, përpara dhe gjatë periudhës që ka lidhje me akuzat, të dyshuarit dhe ndihmësit në mënyrë të përsëritur deklaruan vendosmërinë e tyre për t'i diskretituar Dhomat e Specializuara, për t'ua penguar punën dhe/ose për të shkaktuar prishjen e tyre. Më 26 dhjetor 2017, zoti Haradinaj deklaroi se Dhomat e Specializuara duhej të binin dhe do të binin.¹⁴⁸ Në prill 2020, dy të dyshuarit bënë komente nënçmuese në lidhje me një figurë publike që shprehu mbështetjen për hetimet e ZPS-së¹⁴⁹ dhe në qershor 2020 i denoncuan dëshmitarët si bashkëpunëtorë ose gënjeshtarë.¹⁵⁰ Në dy të parat e tri konferencave për shtyp, zoti Haradinaj deklaroi se DHS-ja duhej të paguante çmimin për zbulimin e

¹⁴⁵ *Shih më lart* para 100-101 (Pika 5), 106 (Pika 6).

¹⁴⁶ 081347-01-TR-ET, f. 3 (z. Gucati); 082106-01-TR-ET, f. 11 (z. Gucati); 081344-02-TR-ET, f. 9 (z. Haradinaj); 081344-03-TR-ET Rishikuar, f. 6 (z. Haradinaj); 081355-02-TR-ET, f. 15 (z. Haradinaj); 081358-02-TR-ET, f. 1, 4 (z. Haradinaj); 081991-01-TR-ET, f. 7 (z. Haradinaj); 081991-03-TR-ET Rishikuar, f. 4-5 (z. Haradinaj); 082106-07-TR-ET, f. 2 (z. Haradinaj).

¹⁴⁷ KSC-BC-2020-07, F00008/RED, para 2-3; F00028/RED, para 2, 5; F00010/RED, para. 4. *Shih edhe* 081347-01-TR-ET, f. 14 (z. Gucati); SPOE00222202-SPOE00222202 (9 shtator 2020, postim në Facebook i z. Haradinaj).

¹⁴⁸ SPOE00222243-00222244-ET, f. 1 (SPOE00222243).

¹⁴⁹ SPOE00222219-00222219-ET (z. Haradinaj); SPOE00222268-00222268-ET (z. Gucati); SPOE00222217-00222217-ET (z. Haradinaj); SPOE00222264-00222267-ET (z. Gucati).

¹⁵⁰ 082733-02-TR-ET, f. 2 (z. Haradinaj); 082733-01-TR-ET, f. 1 (z. Gucati).

dokumenteve dhe se nuk mund të ekzistonte më¹⁵¹ dhe se arsyeja pse OVL-UÇK-ja po i zbulonte dokumentet ishte për ta diskretituar DHS-në.¹⁵² Më 17 shtator 2020, zoti Haradinaj deklaroi se “na po e qesim se po e demantojmë atë profesionalizmin [e DHS-së] që a thirr” dhe bëri të ditur se nuk mendonte se do të parashtroheshin aktakuzat.¹⁵³ Po atë ditë, zoti Gucati shprehu se ishte në interesin e tij dhe të tjerëve t’i hiqej maska DHS-së dhe se ata i kishin zbuluar dokumentet ngaqë DHS-ja ishte e papranueshme për ta.¹⁵⁴ Më 20 shtator 2020, zoti Haradinaj përçoi pritshmërinë e tij se, si pasojë e zbulimit të dokumenteve dhe ngaqë dëshmitarët tani e dinin se u qe zbuluar identiteti. DHS-ja do të prishej dhe shpërbëhej.¹⁵⁵ Po atë ditë, në një transmetim tjetër, zoti Haradinaj deklaroi se ai dhe të tjerët do të publikonin gjithçka që e cenonte ZPS-në.¹⁵⁶ Më 22 shtator 2020, zoti Haradinaj përsëriti akuzat e mëparshme në transmetime, si edhe vendosmërinë e tij për ta turpëruar dhe dëmtuar punën e DHS-së.¹⁵⁷ Po atë ditë, zoti Gucati deklaroi se ishte thelbësore të bindeshin qytetarët e Kosovës se DHS-ja ishte e pavlerë dhe se ai shpresonte që

¹⁵¹ 081344-01-TR-ET, f. 6.

¹⁵² 081344-02-TR-ET, f. 8.

¹⁵³ 082106-07-TR-ET, f. 1 (“[J]anë bisedime që tregon se edhe ngritja e këtyre aktakuzave nëse ai mo hiq s’bien material edhe pse na ka premtu që do të na bien” [...] “Unë po them se kanë me ra poshtë këto aktakuza [...] Prandaj, unë e mendoj që ato aktakuzat që i kanë përmend prandaj edhe s’kanë mujt m’i ngrit ndoshta. E urojmë që s’ti ngrisin kurrë”).

¹⁵⁴ 081347-01-TR-ET, f. 14-15 (“ata mu më thanë në ren, që s’është mirë këto dokumentacione të shumëzohen, të shpërndahen, apo të publikohen emnat e dëshmitarëve [...]. Ne i thamë se nuk jemi të intersu me i shumëzu. S’jemi të intesu me i ru fare. Ne jemi të interesu me demasku këtë Gjykatë Speciale. Me ju tregu juve [mediave] çdo material që na vjen neve këtu, ne do t’jua tregojmë juve se ne jemi kundër Gjykatës Speciale.” [...] “kjo Gjykatë është raciste, është e njëanshme. Për ne është e papranueshme dhe kjo është arsyeja pse ne i publikojmë të gjitha këto dokumentacione.” [...] “Interesi jonë është sa më shumë me i shpërnda në media, edhe me e bind opinionin edhe juve si media, se kjo Gjykatë është e papranueshme edhe gjithmonë kemi qenë kundër sajna.”).

¹⁵⁵ 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 2-3, 10-11 (“këto dosje po bëjnë dy të mira që po dalin. E para, e demaskojnë gjykatën”. [...] “Dhe çka boni kjo [këto dosje]? Këto dosje demaskojnë bashkëpunimin e tyre [të gjykatës] me xhelatin drejtpërdrejt.” [...] “Tash bo vaki shkon krejt gjykata qysh lajmëroi q’ ai i treti se ai ka me pru [dokumente] apet. Do na bjer prapë material.” [...] “O, ka me u rrëxu krejt. Çka lexova, në bazë të cilave dëshmi u bo. Ka me u rrëxu krejt. Sepse tash edhe dëshmitarët që po e dinë që po dihen”).

¹⁵⁶ 081991-02-TR-ET, f. 10 (“Kjo është kauza jon që çdo gjë që kompromenton kët Prokurori ne kem me e qit.”).

¹⁵⁷ 082106-03-TR-ET, f. 15, 18; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 3.

DHS-ja do të shfuqizohej sa më shpejt.¹⁵⁸ Gjatë një interviste tjetër atë ditë, zoti Gucati deklaroi se ishte përgjegjësia e tij ta dëmtonte DHS-në dhe se, nëse ai dhe të tjerët do të kishin mundësi, “do ta hiqnin qafe” dhe do ta shpërbënin DHS-në “brenda pesë minutave”.¹⁵⁹ Më 25 shtator 2020, zoti Haradinaj deklaroi se ishte detyra e tij dhe e të tjerëve të punonin kundër DHS-së.¹⁶⁰ Edhe ndihmësit bënë komente të ngjashme.¹⁶¹ Këto deklarata dëshmojnë se synimet e të dyshuarve dhe të ndihmësve ishin shumë më tepër se thjesht kritika ndaj ZPS-së dhe/ose DHS-së. Në fakt, ata përdorën kërcënime të rënda me dijeninë dhe dëshirën për ta penguar punën e zyrtarëve të DHS-s/ZPS-së në kuadër të procedurave të DHS-së, ose më së paku, vepruan me dijeninë se si pasojë e veprimeve të tyre puna e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së mund të pengohej dhe ata u pajtuan me këtë pasojë.

121. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e sipërpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit kryen veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare brenda kuptimit të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së dhe nenit 15(2) të Ligji, përmes kërcënimit të rëndë.

¹⁵⁸ 082106-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-2.

¹⁵⁹ 082106-01-TR-ET, f. 9, 11 (“Mu më interesojn që [dokumentet] më kan ardh deri në zyre edhe e jemja është çdo form me demantu Gjykatën Speciale [...] imazhin e ksaj Gjykate e shtrejm për toke. [...] Ne muj, kjo Gjykat Speciale për pes minuta, e hjekum krejt. E shpërbëjm krejt kët Gjykat Speciale...”).

¹⁶⁰ 081991-03-TR-ET Rishikuar, f. 2 (“Ne e kem detyr që t’ punojm kundra kësaj Gjykate, ne e kemi detyr që t’ mbrojm antarët tan, ne kët detyr e kem.”).

¹⁶¹ 081931-02-TR-ET, f. 1 (z. Klinaku: “ju thashë [hetuesve], [...] që edhe ato tri kopjet që jau kemi dhënë mediave, ju kemi thënë që mund t’i shumëzoni t’i merrni të gjithë [dokumentet], sepse për neve, edhe këtu haptaz ju them, që Gjykata Speciale për neve është inekzistente dhe ne nuk e kemi pranë as atëherë, as nuk e pranojmë as sot.”); 081355-03-TR-ET, f. 11 (z. Gashi: “po vetë publikimi i ardhjes së mijërave dosjeve në Organizatën e Veteranëve të UÇK-së, ai gjyqtar para se të vendosë për konfirmimin apo jo të aktakuzës ndaj Presidentit Thaçi dhe të tjerëve duhet të mendojë edhe njëherë. Duhet të mendojë dy herë me konfirmu diçka apo mos me konfirmu.”).

6. Pengimi i personave zyrtarë—me anë të veprimit të përbashkët të një grupi (Pika 2)

122. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se midis më së paku 7 dhe 25 shatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit, me anë të veprimit të përbashkët, penguan ose tentuan të pengonin procedurat zyrtare të Dhomave të Specializuara, përfshirë hetimet e ZPS-së.¹⁶²

123. Sa u takon elementeve materiale të veprës penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se, midis së paku 7 dhe 25 shtator 2020, zoti Gucati dhe zoti Haradinaj, përkatësisht në cilësinë e kryetarit dhe të nënkryetarit të OVL-UÇK-së,¹⁶³ vepruan si udhëheqës dhe/ose organizatorë të një grupi që përbëhej prej tyre dhe ndihmësve të tyre, i cili pengoi me anë të veprimit të përbashkët punën e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së në kuadër të procedurave të DHS-së. Në veçanti, siç duket nga më lart,¹⁶⁴ të dyshuarit dhe ndihmësit morën pjesë në organizimin dhe mbajtjen e tri konferencave për shtyp, zbulimin dhe shpërndarjen e paautorizuar të informacionit të mbrojtur, përfshirë të dhënat identifikuese të personave të mbrojtur, në media dhe të tjerë, në emër dhe si përfaqësues të OVL-UÇK-së, dhe në këtë kuadër në mënyrë të përsëritur kërcënuan se do të vijonin shpërndarjen e informacioneve të tilla dhe diskreditimin e ZPS-së dhe/ose DHS-së. Në mënyrë të veçantë, të dyshuarit në mënyrë të përsëritur shpreheshin në shumës “ne”, “neve” dhe “tona” kur flisnin për veprimin e tyre të përbashkët.¹⁶⁵ Si pasojë e, dhe për shkak të, ndikimit (të

¹⁶² Aktakuza, para 4, 25-28, 48.

¹⁶³ 081931-02-TR-ET, f. 1 (z. Klinaku: “Unë veproj me vendim të Hysni Gucatit, kryetarit”). *Shih edhe* 081344-01-TR-ET, f. 12; 081344-02-TR-ET, f. 2.

¹⁶⁴ *Shih më lart* para 100-101 (Pika 5), 105-106 (Pika 6), 119 (Pika 1).

¹⁶⁵ 082106-07-TR-ET, f. 1 (z. Haradinaj: “na po e qesim se po e demantojmë atë profesionalizmin e tyre [të DHS-së] që a thirr”); 081347-01-TR-ET, f. 14-15 (z. Gucati: “ata mu më thanë në ren, që s’është mirë këto dokumentacione të shumëzohen, të shpërndahen, apo të publikohen emnat e dëshmitarëve [...]. Ne i thamë se nuk jemi të intersu me i shumëzë. S’jemi të interesu me i ru fare. Ne jemi të interesu me demasku këtë Gjykatë Speciale. Me ju tregu juve [mediave] çdo material që na vjen neve këtu, ne do t’ju tregojmë juve se ne jemi kundër Gjykatës Speciale.” [...] “kjo Gjykatë është raciste, është e

mundshëm) te dëshmitarët dhe te të tjerët që bashkëpunojnë me ZPS-në dhe/ose DHS-në, të dyshuarit e penguan dhe/ose e vonuan punën e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së, sidomos të prokurorëve, hetuesve të ZPS-së, dhe të punonjësve të DHS-së, në kuadër të procedurave të DHS-së, duke i penguar në këtë mënyrë zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kryerjen e detyrave zyrtare.¹⁶⁶

124. Sa i takon elementit mendor të veprës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të bëra në Pikën 1.¹⁶⁷

125. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e sipërpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të dyshuarit dhe ndihmësit kryen veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare brenda kuptimit të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së dhe nenit 15(2) të Ligji, përmes kërcënimit të rëndë.

B. FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE NË AKTAKUZË

1. Kryerja

126. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se të dyshuarit kryen veprat penale të përfshira në Pikat 1-6, sipas nenit 17 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.¹⁶⁸

njëanshme. Për ne është e papranueshme dhe kjo është arsyeja pse ne i publikojmë të gjitha këto dokumentacione." [...] "Interesi jonë është sa më shumë me i shpërnda në media, edhe me e bind opinionin edhe juve si media, se kjo Gjykatë është e papranueshme edhe gjithmonë kemi qenë kundër sajna."); 081991-02-TR-ET, f. 10 (z. Haradinaj: "Kjo është kauza jonë që çdo gjë që kompromenton këtë Prokurori në kem me e qit."); 082106-01-TR-ET, f. 11 (z. Gucati: "Ne muj, kjo Gjykat Speciale për pes minuta, e hjekum krejt. E shpërbëjm krejt këtë Gjykat Speciale."); 081991-03-TR-ET Rishikuar, f. 2 (z. Haradinaj: "Ne e kem detyr që t'punojm kundra kësaj Gjykate, ne e kemi detyr që t'mbrojm antarët tan, ne këtë detyr e kem.").

¹⁶⁶ *Shih më lart* para 119-120 (Pika 1).

¹⁶⁷ *Shih më lart* para. 120 (Pika 1).

¹⁶⁸ Aktakuza, para 37, 47(i), 48.

127. Në lidhje me elementet objektive¹⁶⁹ dhe subjektive¹⁷⁰ të kryerjes fizike nga të dyshuarit të veprave të lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme në Pikat 1-6.

128. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshimi i bazuar mirë se të dyshuarit kryen veprat penale të Pikave 1-6, brenda kuptimit të nenit 17 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.

2. Bashkëkryerja

129. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se, krahas përgjegjësisë penale të tyre për kryerjen dhe si alternativë e saj, të dyshuarit i kryen bashkërisht veprat e paraqitura në Pikat 1-6 duke marrë pjesë në to ose duke kontribuar thelbësisht në kryerjen e tyre, sipas nenit 31 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.¹⁷¹

130. Sa u takon elementeve të kësaj forme përgjegjësie penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se, siç përshkruhet në lidhje me Pikat 1 dhe 3-6,¹⁷² të dyshuarit vepruan në mënyrë të koordinuar, ku secili mori pjesë ose kontribuoi thelbësisht në kryerjen e veprave penale.

131. Sa i takon elementit subjektiv të kësaj forme përgjegjësie penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme në Pikat 1 dhe 3-6.¹⁷³

¹⁶⁹ *Shih më lart* para 100-101 (Pika 5), 105-107 (Pika 6), 111 (Pika 4), 115 (Pika 3), 119 (Pika 1) dhe 123 (Pika 2).

¹⁷⁰ *Shih më lart* para 102 (Pika 5), 108 (Pika 6), 112 (Pika 4), 116 (Pika 3), 120 (Pika 1) dhe 124 (Pika 2).

¹⁷¹ Aktakuza, para 39-40, 47(i), 48; Përmbledhja e hollësishme, f. 49.

¹⁷² *Shih më lart* para 100-101 (Pika 5), 105-107 (Pika 6), 111 (Pika 4), 115 (Pika 3) dhe 119 (Pika 1). *Shih edhe më lart* para. 87 (Bashkëkryerja).

¹⁷³ *Shih më lart* para 102 (Pika 5), 108 (Pika 6), 112 (Pika 4), 116 (Pika 3) dhe 120 (Pika 1). *Shih edhe lart* para. 87 (Bashkëkryerja).

132. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se të dyshuarit i bashkëkryen veprat penale të paraqitura në Pikat 1 dhe 3-6, brenda kuptimit të nenit 31 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.

3. Nxitja

133. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se, krahas përgjegjesisë penale të tyre për kryerjen dhe/ose bashkëkryerjen dhe si alternativë e saj, të dyshuarit nxitën njëri-tjetrin, ndihmësit dhe disa të tjerë, që të kryenin veprat penale të Pikave 1-6, sipas nenit 32(1) të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.¹⁷⁴ Krahas këtyre dhe si alternativë, ZPS-ja pretendon se të dyshuarit janë përgjegjës: (i) në bazë të nenit 32(2) të KPK-së, për nxitjen e kryerjes së veprave penale të Pikave 1-6, edhe pse vepra të tilla u tentuan por në përfundim nuk u kryen;¹⁷⁵ dhe (ii) në bazë të nenit 32(3) të KPK-së, për nxitjen e veprave penale të Pikave 1-3 dhe 6, edhe pse në përfundim këto vepra penale as u kryen, as u tentuan.¹⁷⁶

134. Sa u takon elementeve objektive të kësaj forme të përgjegjesisë penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se të dyshuarit më së paku nxitën kryerjen e veprave penale (të tentuara) të paraqitura në Pikat 1-6 në mënyrën në vijim. Së pari, ata inkurajuan njëri-tjetrin dhe ndihmësit që t'i kryenin këto vepra penale duke përmendur vazhdimisht vendosmërinë dhe detyrën e tyre për ta publikuar dhe shpërndarë informacionin e mbrojtur dhe për ta dëmtuar DHS-në, siç përshkruhet në Pikën 1.¹⁷⁷ Së dyti, ata nxitën, udhëzuan dhe ushtruan presion mbi përfaqësuesit e shtypit që të merrnin, të incizonin dhe të shpërndanin informacionin e mbrojtur. Në veçanti, në tri

¹⁷⁴ Aktakuza, para 41, 47(iv), 48.

¹⁷⁵ Aktakuza, para 42, 47(v), 48.

¹⁷⁶ Aktakuza, para 43, 47(vi), 48.

¹⁷⁷ *Shih më lart* para. 120 (Pika 1).

konferencat për shtyp, të dyshuarit i nxitën të pranishmit të merrnin një kopje të dokumenteve dhe/ose të shikonin emrat dhe deklaratat.¹⁷⁸ Në të fundit e tri konferencave për shtyp, zoti Haradinaj i nxiti përfaqësuesit e shtypit “të këqyrni punën tuaj” dhe tha se “të gjithë së bashku ne duhet ta kryejmë një detyrë”¹⁷⁹ dhe i inkurajoi të bënin fotografi të dokumenteve.¹⁸⁰ Në raste të tjera, zoti Haradinaj i nxiti dhe ushtroi presion mbi përfaqësuesit e shtypit t’i publikonin dokumentet.¹⁸¹ Së treti, ata inkurajuan çdo person që kishte në dorë informacionin e mbrojtur që të vijonte t’ia jepte OVL-UÇK-së,¹⁸² duke premtuar se do të vijonin t’i zbulonin dokumentet e marra në të ardhmen.¹⁸³

135. Materiali mbështetës më tej tregon se të dyshuarit dhe ndihmësit kryen veprat e paraqitura në Pikat 1-6.¹⁸⁴ Krahas kësaj dhe si alternativë, materiali mbështetës tregon se të dyshuarit dhe ndihmësit tentuan të kryenin veprat penale të paraqitura në Pikat 1-4 dhe 6.¹⁸⁵ Gjithashtu, materiali mbështetës tregon se të paktën disa prej përfaqësuesve të shtypit e publikuan informacionin e mbrojtur dhe/ose zbuluan identitetin e personave të mbrojtur. Në veçanti, pas tri konferencave për shtyp, në median e shtypur dhe në internet dolën artikuj ku publikohej, në formë referimi apo fotografie, informacioni i mbrojtur dhe zbulohet identiteti dhe/ose të dhënat personale të personave të mbrojtur.¹⁸⁶

¹⁷⁸ 081344-01-TR-ET, f. 11, 13 (z. Haradinaj); 081344-02-TR-ET, f. 1 (z. Gucati), 8 (z. Haradinaj); 081344-03-TR-ET, f. 2 (z. Gucati), 4, 12 (z. Haradinaj).

¹⁷⁹ 081344-03-TR-ET, f. 4, 9.

¹⁸⁰ 081344-03-TR-ET, f. 12.

¹⁸¹ 082106-06-TR-ET, f. 3; 082106-03-TR-ET, f. 20; 081355-02-TR-ET, f. 7, 16; 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 8-9; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 4.

¹⁸² 082106-01-TR-ET, f. 11 (z. Gucati); 082106-02-TR-ET Rishikuar, f. 2 (z. Gucati); 081344-03-TR-ET Rishikuar, f. 3 (z. Haradinaj); 081355-02-TR-ET, f. 3-5 (z. Haradinaj); 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 1-2, 13; SPOE00220800-SPOE00220800-ET, f. 1 (SPOE00220800) (z. Haradinaj).

¹⁸³ *Shih më lart* p.sh. 83 (Pika 5).

¹⁸⁴ *Shih më lart* para 99-125 (Pikat 1-6).

¹⁸⁵ *Shih më poshtë* para 147-149 (Tentativa).

¹⁸⁶ 081364-081367-ET; 081361-081362-ET; 081914-081919-ET; 081371-081373-ET; 081374-081377-ET; 081381-081383-ET; 081392-01-TR-ET; 081395-081398-ET; 081405-01-TR-ET; 081414-081415-ET; 081422-01-TR-ET. *Shih edhe* 084015-084026, para 13-18, 36-74 (084016-084025).

136. Sa u takon elementeve subjektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, aktet e lartpërmendura të qëllimshme të inkurajimit, shtytjes dhe trysnisë dëshmojnë synimin e të dyshuarve për të nxitur kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6, përfshirë edhe synimin konkret të paraqitur në Pikën 4.

137. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se të dyshuarit nxitën kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6 dhe se këto vepra penale janë kryer, brenda kuptimit të nenit 32(1) të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit. Krahas kësaj dhe si alternativë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar i mirë se të dyshuarit: (i) nxitën kryerjen e tentuar të veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6, brenda kuptimit të nenit 32(2) të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit; dhe (ii) nxitën kryerjen e atyre veprave penale të paraqitura në Pikat 1-3 dhe 6 të cilat as u kryen dhe as u tentuan, brenda kuptimit të nenit 32(3) të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.

4. Ndhima

138. Në aktakuzë, ZPS-ja pretendon se, krahas përgjegjësisë penale të tyre për kryerjen dhe/ose bashkëkryerjen dhe si alternativë të kësaj përgjegjësie, të dyshuarit ndihmuan njëri-tjetrin, ndihmësit e tyre dhe disa të tjerë në kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6, sipas nenit 33 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.¹⁸⁷

139. Sa u takon elementeve objektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se të dyshuarit më së paku e ndihmuan njëri-tjetrin, ndihmësit e tyre dhe disa përfaqësues të shtypit në kryerjen e veprave penale (të tentuara) të paraqitura në

¹⁸⁷ Aktakuza, para 44, 47(iv), 48.

Pikat 1-6. Së pari, të dyshuarit ndihmuan njëri-tjetrin dhe ndihmësit e tyre në kryerjen e veprave: (i) përmes këqyrjes së informacionit të mbrojtur dhe/ose pjesëmarrjes në vendimet për ta zbuluar;¹⁸⁸ (ii) përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në transmetime [televizive], përfshirë tri konferencat për shtyp, ku u zbulua dhe u shpërnda informacioni i mbrojtur;¹⁸⁹ (iii) përmes shpërndarjes së mëtejshme të kopjeve të informacionit të mbrojtur;¹⁹⁰ (iv) përmes deklaratave nënçmuese kundër dhënësve të informacionit;¹⁹¹ dhe (v) përmes deklarimit në mënyrë të përsëritur të vendosmërisë së tyre për të diskretituar Dhomat e Specializuara, për të penguar punën e saj dhe/ose për të shkaktuar prishjen e saj.¹⁹² Së dyti, të dyshuarit ndihmuan disa përfaqësues të shtypit, që publikuan informacionin e mbrojtur dhe të dhënat e personave të mbrojtur,¹⁹³ në kryerjen e veprave penale: (i) përmes zbulimit dhe shpërndarjes së informacionit të mbrojtur;¹⁹⁴ dhe (ii) përmes zbulimit të identitetit dhe/ose të dhënave personale të personave të mbrojtur.¹⁹⁵

140. Sa u takon elementeve subjektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, aktet e lartpërmendura dëshmojnë synimin e të dyshuarve për të mundësuar mjetet dhe kushtet, si edhe për të hequr pengesat, për kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6.

141. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se të dyshuarit ndihmuan

¹⁸⁸ 081344-01-TR-ET, f. 1-2; 081355-04-TR-ET Rishikuar, f. 1, 3-4, 8, 12; 082106-02-TR-ET Rishikuar, f. 2. *Shih më lart* para 100-101 (Pika 5).

¹⁸⁹ *Shih më lart* para 100-101 (Pika 5).

¹⁹⁰ *Shih më lart* para. 101 (Pika 5).

¹⁹¹ *Shih më lart* para. 111 (Pika 4).

¹⁹² *Shih më lart* para. 120 (Pika 1).

¹⁹³ *Shih më lart* poshtëshënimi 186 (Nxitja).

¹⁹⁴ *Shih më lart* para 100-103 (Pika 5).

¹⁹⁵ *Shih më lart* para 105-109 (Pika 6).

në kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-6, brenda kuptimit të nenit 33 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.

5. Marrëveshje për të kryer vepër penale

142. Në aktakuzë, ZPS-ja pretendon se, krahas përgjegjesisë penale për kryerjen dhe/ose bashkëkryerjen dhe si alternativë të kësaj përgjegjësie, të dyshuarit u morën vesh të kryenin veprat e paraqitura në Pikat 1-6 dhe ndërmorën veprime thelbësore në drejtim të kryerjes së tyre, sipas nenit 35 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.¹⁹⁶

143. Sa u takon elementeve objektive të kësaj forme të përgjegjesisë penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se të dyshuarit, përkatësisht me cilësinë e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të OVL-UÇK-së,¹⁹⁷ u morën vesh reciprokisht, gjithashtu edhe me ndihmësit e tjerë, të kryenin veprat penale të paraqitura në Pikat 1-6 dhe më së paku ndërmorën hapa përgatitorë thelbësorë për kryerjen e tyre. Në veçanti, të dyshuarit në mënyrë të përsëritur përdorën përemrat në vetën e parë shumës “ne”, “neve” dhe “tona” për të përshkruar synimet dhe veprimet e tyre të përbashkëta.¹⁹⁸ Sa u takon hapave përgatitorë thelbësorë të ndërmarrë nga të dyshuarit dhe ndihmësit për kryerjen e veprave penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve për Pikat 1-6.¹⁹⁹

144. Sa i takon elementit subjektiv të kësaj forme përgjegjësie penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme në Pikat 1-6.²⁰⁰

¹⁹⁶ Aktakuza, para 39-40, 47(iii), 48.

¹⁹⁷ 081931-02-TR-ET, f. 1 (z. Klinaku: “Unë veproj me vendim të Hysni Gucatit, kryetarit”). *Shih edhe* 081344-01-TR-ET, f. 12; 081344-02-TR-ET, f. 2.

¹⁹⁸ *Shih më lart* poshtëshënimi 165 (Pika 6).

¹⁹⁹ *Shih më lart* para 100-101 (Pika 5), 105-107 (Pika 6), 111 (Pika 4), 115 (Pika 3), 119 (Pika 1) dhe 123 (Pika 2).

²⁰⁰ *Shih më lart* para 102 (Pika 5), 108 (Pika 6), 112 (Pika 4), 116 (Pika 3), 120 (Pika 1) dhe 124 (Pika 2).

145. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se të dyshuarit u morën vesh të kryenin veprat penale të paraqitura në Pikat 1-6 dhe ndërmorën veprime thelbësore në drejtim për kryerjen e tyre, brenda kuptimit të nenit 35 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.

6. Tentativa

146. Në Aktakuzë, ZPS-ja pretendon se, krahas përgjegjësisë së tyre penale për kryerjen dhe/ose bashkëkryerjen, dhe si alternativë të kësaj përgjegjësie, të dyshuarit tentuan kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-4 dhe 6, sipas nenit 28 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.²⁰¹

147. Sa u takon elementeve objektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se të dyshuarit më së paku ndërmorën veprim për kryerjen e veprave penale të paraqitura në Pikat 1-4 dhe 6 duke filluar kryerjen, përmes përmbushjes së një ose më shumë prej elementeve të tyre materiale. Sa u takon veprimeve konkrete në të cilat u angazhuan të dyshuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të bëra në Pikat 1-6.²⁰²

148. Sa i takon elementit subjektiv të kësaj forme të përgjegjësisë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme në Pikat 1-4 dhe 6.²⁰³

149. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston dyshimi i bazuar mirë se të dyshuarit tentuan

²⁰¹ Aktakuza, para 38, 47(ii), 48.

²⁰² *Shih më lart* para 100-101 (Pika 5), 105-107 (Pika 6), 111 (Pika 4), 115 (Pika 3), 119 (Pika 1) dhe 123 (Pika 2). Megjithëse tentativa nuk është e ndëshkueshme brenda kuadrit të Pikës 5, veprimet e përshkuara në atë pikë frymëzojnë tentativën e të dyshuarve për kryerjen e veprave penale të Pikave 1-4 dhe 6.

²⁰³ *Shih më lart* para 108 (Pika 6), 112 (Pika 4), 116 (Pika 3), 120 (Pika 1) dhe 124 (Pika 2).

kryerjen e veprave të paraqitura në Pikat 1-4 dhe 6, brenda kuptimit të nenit 28 të KPK-së dhe nenit 16(3) të Ligjit.

VII.KËRKESAT SHOQËRUESE PËR RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT

150. Përgjithësisht, rregulla 88(1) e Rregullores përcakton që aktakuza bëhet publike pas konfirmimit të saj. Gjithashtu, sipas rregullave 95(1) dhe (2)(b) dhe 102(1)(a) të Rregullores, nxjerrja e materialeve përfshirë edhe nxjerrjen e emrave të dëshmitarëve dhe viktimave, kryhet pas paraqitjes së parë të të akuzuarit në lidhje me të cilin është konfirmuar aktakuzë. Megjithatë, në rrethana të posaçme, sipas rregullave 88(2) dhe 105(1) të Rregullores, ZPS-ja mund të bëjë kërkesë që mosnxjerrja e përkohshme e aktakuzës, dokumenteve shoqëruese të saj dhe e identiteteve të viktimave dhe dëshmitarëve të vazhdojë pas konfirmimit të aktakuzës ose paraqitjes së parë të të akuzuarit, sipas rastit. Theksohet se masat në bazë të rregullës 105(1) kanë natyrë të përkohshme dhe mundësojnë mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave të cenueshme deri në dorëzimin e kërkesës për masa mbrojtëse.

151. Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve të lartpërmendura se të dyshuarit: (i) zbuluan në raste të shumta dhe pa autorizim, megjithëse pranuan se ishte e ndaluar, informacionin e mbrojtur si edhe identitetet dhe/ose të dhënat personale të [REDAKTUAR] personave të mbrojtur, përfshirë edhe të atyre që i kishin informacione ZPS-së;²⁰⁴ (ii) u hakmorën kundër dhënësve të informacionit;²⁰⁵ (iii) frikësuan dhënësit e mundshëm të informacionit;²⁰⁶ dhe (iv) si rezultat i veprimeve të lartpërmendura, penguan dhe/ose vonuan punën e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së në kuadër të procedurave të DHS-së.²⁰⁷ Për rrjedhojë,

²⁰⁴ Shih më lart para 100-103 (Pika 5) dhe 105-109 (Pika 6).

²⁰⁵ Shih më lart para 111-113 (Pika 4).

²⁰⁶ Shih më lart para 115-117 (Pika 3).

²⁰⁷ Shih më lart para 119-121 (Pika 1) dhe 123-125 (Pika 2).

Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se të dyshuarit kanë motiv për t'i penguar procedurat dhe, duke marrë parasysh vendosmërinë e tyre për diskreditimin e DHS-së, mund të kryejnë vepra penale të ngjashme të tjera.

152. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ZPS-ja ka treguar se ekzistojnë arsye të vlefshme që përlligjin rrethanat e veçanta të cilat, në bazë të rregullës 88(2) të Rregullores, lejojnë mosnxjerrjen e përkohshme publike të Parashtrimit të aktakuzës së ZPS-së së bashku me shtojcat ("dokumentet shoqëruese"). Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konstaton se ZPS-ja ka treguar se ekzistojnë rrethana të veçanta, sipas rregullës 105(1) të Rregullores, që përlligjin mosnxjerrjen e përkohshme të identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave deri sa të jenë urdhëruar masa mbrojtëse të përshtatshme.

153. Duke pasur parasysh se të dyshuarit ndodhen aktualisht në paraburgim dhe se, sipas rregullave 87(6) dhe 92 të Rregullores, paraqitja e tyre e parë duhet mbajtur pa vonesë, aktakuza e konfirmuar në paragrafin 155 ("Aktakuza e Konfirmuar"), bëhet publike,²⁰⁸ me redaktimet e nevojshme, pasi t'u jetë dorëzuar të Akuzuarve, në pajtim me rregullën 87(1) të Rregullores. Të Akuzuarve u dorëzohet Aktakuza e Konfirmuar (e redaktuar) rreptësisht konfidenciale në pajtim me rregullat 87(1) dhe 105(1) të Rregullores. Në pajtim me rregullën 88(3) të Rregullores, ZPS-ja ose Administratori mund t'ua bëjë të njohur versionin (e redaktuar) të Aktakuzës së Konfirmuar ose pjesë të saj autoriteteve të Kosovës, të një shteti të tretë apo subjekti tjetër, në qoftë se e gjykon të nevojshme për hetime ose ndjekje penale.

²⁰⁸ Në kuadër të këtij vendimi, 'publiku' janë të gjithë personat, organizatat, subjektet, shtetet e treta, klientët, shoqatat dhe grupet, duke përfshirë mediat, me përjashtim të gjykatësve të Dhomave të Specializuara (dhe personelit të tyre), Zyres Administrative, ZPS-së, dhe të akuzuarve.

154. Mosnxjerrja e dokumenteve shoqëruese dhe materialit mbështetës të Aktakuzës së Konfirmuar zbatohet deri në një urdhër të mëtejshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, sikurse parashihet në rregullën 88(2) të Rregullores. Megjithatë, materiali mbështetës me redaktimet e nevojshme u vihet në dispozicion të Akuzuarve jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e tyre e parë, sipas rregullave 102(1)(a) dhe 105(1) të Rregullores.

VIII. VENDIM

155. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

a. **KONFIRMON** akuzat e mëposhtme kundër zotit Gucati dhe zotit Haradinaj:

- i. pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të kërcënimit të rëndë, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 401(1) dhe (5) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 1);
- ii. pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 2);
- iii. frikësim gjatë procedurës penale, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 387 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 3);
- iv. hakmarrje, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(2), 33, 35 dhe 388(1) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 4);
- v. shkelje e fshehtësisë së procedurës, përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të mbrojtur, e ndëshkueshme në bazë të

neneve 17, 31, 32(1)-(2), 33, 35 dhe 392(1) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 5); dhe

- vi. shkelje e fshehtësisë së procedurës, përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe/ose të dhënave personale të personave të mbrojtur, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 392(2)-(3) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 6);
- b. **URDHËRON** Prokurorin e Specializuar që, brenda **ditës së hënë, datë 14 dhjetor 2020, ora 12:00**, të parashtrojë një aktakuzë të redaktuar, duke mbajtur parasysh konstatimet e bëra në paragrafët 87, 115, 117, 119, 121 dhe 132 e cila do të konsiderohet si “Aktakuza e Konfirmuar” rreptësisht konfidenciale;
- c. **AUTORIZON** ZPS-në të redaktojë çdo të dhënë identifikuese të viktimave ose dëshmitarëve ose çdo informacion konfidencial në Aktakuzën e Konfirmuar, dokumentet shoqëruese dhe materialin mbështetës si dhe të caktojë dhe të përdorë pseudonime të përkohshme për këta viktima dhe dëshmitarë;
- d. **URDHËRON** ZPS-në të parashtrojë një version rreptësisht konfidencial (të redaktuar) të Aktakuzës së Konfirmuar brenda **ditës së hënë, 14 dhjetor 2020, ora 12:00**;
- e. **URDHËRON** Zyrën Administrative që, në këshillim me ZPS-në, t’u dorëzojë të Akuzuarve versionin rreptësisht konfidencial (të redaktuar) të Aktakuzës së Konfirmuar, brenda **ditës së hënë, 14 dhjetor 2020, ora 14:00**;
- f. **URDHËRON** ZPS-në të parashtrojë një version publik (të redaktuar) të Aktakuzës së Konfirmuar dhe **URDHËRON** nxjerrjen e atij versioni në publik brenda **ditës së hënë, 14 dhjetor 2020, ora 16:00**;

- g. **AUTORIZON** ZPS-në dhe Administratoren t'ua bëjë të njohur Aktakuzën e Konfirmuar rreptësisht konfidenciale (të redaktuar), ose pjesë të saj, autoriteteve të Kosovës, të një shteti të tretë ose subjekti tjetër, në qoftë se gjykohet e nevojshme për hetime ose ndjekje penale;
- h. **URDHËRON** mosnxjerrjen e dokumenteve shoqëruese dhe materialit mbështetës deri në një urdhër të mëtejshëm;
- i. **I KËRKON** ZPS-së të depozitojë brenda **ditës së premte, 18 dhjetor 2020**, parashtrime me shkrim rreptësisht konfidenciale *ex parte*, nëse ka, për të propozuar bërjen e redaktimeve në këtë vendim, me qëllim që t'i vendoset në dispozicion Mbrojtjes dhe publikut; dhe
- j. **URDHËRON** ZPS-në të paraqesë kërkesë për masa mbrojtëse, nëse ka, në lidhje me viktimat dhe dëshmitarët e identifikuar në Aktakuzën e Konfirmuar, dokumentet shoqëruese dhe materialin mbështetës brenda **ditës së mërkurë, 6 janar 2021**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 11 dhjetor 2020
Në Hagë, Holandë.